



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RAPORTI VJETOR 2010

FJALA HYRËSE

Të dashur lexues,

Ky Raport vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin kalendarik 2010 është përpiluar në pajtim me dispozitat e Nenit 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (LRE), për t'iu dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim, shqyrtim e miratim.

Raporti përfshin informacione të rëndësishme lidhur me aktivitetet e zhvilluara në kuadër të fushëveprimit të funksioneve, detyrave dhe kompetencave të ZRRE-së, përmes monitorimit të vazhdueshëm të aktiviteteve të licencuara në sektorin e energjisë në Kosovë, të paraqitjes së të dhënave, fakteve e rezultateve më esenciale procedurale, teknike e komerciale, të shoqëruara me analiza dhe përfundime përkatëse. Rëndësi e veçantë i është kushtuar monitorimit të konkurrencës dhe transparencës së tregjeve të energjisë në Kosovë e në rajon.

Vend të rëndësishëm në raport zë Raporti financiar i ZRRE-së për vitin paraprak, ku përfshihen të hyrat vetjake të ZRRE-së, të mbledhura nga ndërmarrjet e licencuara të energjisë, për shërbimet që kryen për to, si dhe shpenzimet e bëra për kryerjen e veprimtarive të parapara sipas dispozitave të neneve 18 dhe 21 të LRE.

Për ta lehtësuar procesin e ristrukturimit dhe të liberalizimit të aktiviteteve në sektorin e energjisë, qeveria ka hartuar Projektligjet kryesore të sektorit të energjisë, në pajtueshmëri me "Pakon e dytë" të legjislacionit të BE-së, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Brenda një periudhe ZRRE duhet ta kompletojë legjislacionin dytësor, me hartimin e miratimin e rregullave të reja, në përputhshmëri me legjislacionin primar të miratuar.

Në ndërmarrjet energjetike janë kryer riparime e investime sipas planeve të tyre. Pas këtyre investimeve, gjendja e rrjetit të transmissioinit është përmirësuar dukshëm, që ka rezultuar me eliminimin e fyteve të ngushta, përmirësimin e profilit të tensioneve, uljen e dukshme të humbjeve teknike në transmissioin dhe me rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji.

Rrjeti i shpërndarjes, edhe më tutje, mbetet në gjendje jo të mirë. Investimet e pamjaftueshme dhe rritja e konsumit ka rezultuar me humbje të larta teknike të energjisë dhe me furnizim jocilësor të konsumatorëve.

Qeveria, me ndihmën e konsulentëve të jashtëm, ka vazhduar procesin e përgatitjeve për privatizimin e rrjetit të shpërndarjes dhe të furnizimit të KEK-ut.

Edhe në këtë vit energjia e prodhuar nga gjeneratorët vendorë nuk ka qenë e mjaftueshme për mbulimin e kërkesave për furnizim të konsumatorëve, andaj, për plotësimin e një pjese të mungesave në furnizim, është importuar një sasi e energjisë elektrike. Përkundër kësaj, në periudha të ndryshme, sidomos në orët e pikut, ka pasur shkurtime të furnizimit me energji.

Furnizuesi publik, edhe në këtë vit, është ballafaquar me problemet e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë nga konsumatorët e pandërgjegjshëm dhe me vështirësi të arkëtimit të energjisë së faturuar. Qeveria ka vazhduar ta subvencionojë KEK-un nga Buxheti i Konsoliduar, për një sasi të importeve të energjisë elektrike dhe për mbulimin e një sasive të energjisë për konsumatorët në nevojë, veçanërisht për ata që jetojnë me ndihma sociale.

Gjatë vitit 2010, për herë të katërt, janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar të hyrat e lejuara për aktivitetet e ndërmarrjeve të energjisë, si dhe struktura dhe nivelet e tarifave të energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore për konsumatorët e rregulluar. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që niveli i tarifave të mos ndryshojë, ngase është vlerësuar se niveli ekzistues i tarifave do t'iu mundësojë të licencuarve t'iu mbledhin të hyrat e nevojshme për mirëmbajtje dhe operim adekuat të pajisjeve dhe për ofrim të shërbimeve të furnizimit me energji.

Projekti i rikonfiguruar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese "TC Kosova e Re" ka vazhduar. Megjithatë, ende nuk janë finalizuar dhe vendosur termat e referencës për t'iu dërguar investitorëve potencialë për paraqitjen e ofertave përfundimtare të tyre për ndërtim.

ZRRE ka bërë hapa të rëndësishëm në lëmin e shfrytëzimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE), duke aprovuar pothuajse të gjitha rregullat dhe procedurat e nevojshme për të kompletuar kuadrin rregullator për realizimin e ndërtimit të kapaciteteve nga BRE. Gjatë këtij viti, ZRRE ka lëshuar tri autorizime fillestare dhe një autorizim përfundimtar për ndërtimin e gjeneratorëve të rinj, kryesisht nga BRE me erë.

Me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimit e të furnizimit të sigurt të konsumatorëve, ZRRE ka aprovuar Standardet e kualitetit të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike, të cilat duhet të përmbushen nga të licencuarit.

Me keqardhje duhet të theksohet se sektori i ngrohjes qendrore nuk i ka përmbushur as për së afërmi detyrimet e tij ndaj konsumatorëve. Sezonet e ngrohjes 2009/2010 e 2010/2011 janë përcjellë me probleme të shumta; furnizim të mangët, ndërprerje disaditëshe, deri me ndërprerje të plotë të ngrohjes para përfundimit të sezonit. Shkaktar kryesor ka qenë mungesa e mjeteve financiare për të siguruar lëndën djegëse me kohë dhe në sasi të duhur. Kjo gjendje është vështirësuar edhe më tepër nga niveli i ulët i arkëtimit, rritja enorme e çmimeve të lëndës djegëse dhe nga mosmarrëveshjet e administratës qendrore me atë komunale rreth menaxhimit dhe sigurimit të subvencioneve.

Me një donacion të kFw ka filluar hartimi i studimit të fizibilitetit të një projekti të ko-gjenerimit të energjisë termike nga TC Kosova B, me kapacitet prej 120 MWt, që do të përmirësonte dukshëm furnizimin e Prishtinës me ngrohje të qëndrueshme dhe cilësore. Për ta lehtësuar realizimin e një projekti të tillë, ZRRE ka përfshirë ko-gjenerimin në kuadrin rregullator dytësor.

Për zbatimin e strategjisë dhe të politikave në sektorin e energjisë, ZRRE ka bashkëpunuar me komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës, me ministritë relevante të qeverisë, me përfaqësuesit e industrisë dhe të konsumatorëve, si dhe me të gjitha palët e tjera të interesit në këtë sektor.

ZRRE ka vazhduar të jetë aktive në të gjitha aktivitetet dhe proceset që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (KEJL), në Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (BRKE) dhe në të gjitha forumet, komisionet e grupet punuese në kuadër të tij. Po ashtu, ZRRE ka vazhduar bashkëpunimin me Asociacionin Regjional të Rregullatorëve të Energjisë (ERRE) dhe me institucione e organizata të tjera ndërkombëtare në lëmin e rregullimit. Edhe në këtë vit kanë vazhduar aktivitetet në kuadër të marrëveshjes së partneritetit midis ZRRE-së dhe Rregullatorit-Komisionit Komercial të shtetit Illionis (ICC), SHBA.

Bordi dhe i gjithë stafi i ZRRE-së janë krenarë për mundësinë e tyre për të ofruar një sistem rregullator efikas dhe efektiv në sektorin e energjisë në Kosovë, duke zbatuar përvojat më të mira profesionale e shkencore nga lëmi i rregullimit, duke u kujdesur për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut. Arritjet tona në vitin fiskal 2010 pasqyrojnë angazhimin tonë të vazhdueshëm për një zhvillim të suksesshëm të sektorit të energjisë, në të mirë të konsumatorëve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Me respekt,

Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE	1
PËRMBAJTJA.....	3
1. njohuri TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI	7
1.1 Mandati i zyrës së rregullatorit për energji	7
1.2 Struktura organizative e ZRRE-së	7
1.2.1 Bordi.....	7
1.2.2 Departamenti ligjor dhe i licencimit.....	8
1.2.3 Departamenti për furnizim me energji dhe strukturë të tregut	8
1.2.4 Departamenti i tarifave dhe çmimeve	8
1.2.5 Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve	8
1.2.6 Grupi teknik këshillëdhënës	8
1.3 Ngritja e kapaciteteve të ZRRE-së – projektet e asistencës teknike trajnimet dhe punëtoritë	9
1.3.1. Projektet e asistencës teknike.....	9
1.3.2 Trajnimet dhe punëtoritë	10
1.4 Komunikimi me publikun	10
2. RAPORTI FINANCIAR.....	11
2.1 Të hyrat	11
2.2 Buxheti.....	11
2.2.1 Shpenzimet buxhetore	12
3. KOMPLETIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE RREGULLATIVE	15
3.1 Hartimi dhe finalizimi i legjislacionit primar për energji.....	15
3.2 Hartimi dhe finalizimi i legjislacionit sekondar	15
3.3 Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga BRE.....	16
3.4 Licencimi i ndërmarrjeve të energjisë	17
3.5 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë	18
3.6 Dokumentet e hartuara nga të licencuarit.....	19
4 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË	20
4.1 Rrjeti i transmisionit	20
4.1.1 Humbjet e energjisë elektrike në transmision	24
4.2 Rrjeti i shpërndarjes.....	25
4.2.1 Humbjet në shpërndarje	26
4.3 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike	27
4.3.1 Kontinuiteti i furnizimit	27
4.3.2 Cilësia e tensionit	28
4.3.3 Cilësia komerciale	28
4.4 Prodhimi dhe konsumi i linjit.....	28
4.5 Prodhimi i energjisë elektrike	29
4.6 Konsumi i energjisë elektrike.....	32
4.6.1 Konsumi në shpërndarje.....	34
4.7 Faturimi dhe arkëtimi	36
4.8 Tregu i energjisë elektrike	36
4.8.1 Rrjedhat e energjisë elektrike.....	37



4.8.2	Importi dhe eksporti i energjisë elektrike.....	38
4.8.3	Krahasimi i çmimeve të importit me vendet e rajonit.....	40
5	Shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike	41
5.1	Shqyrtimi i katërt i tarifave të energjisë elektrike.....	41
5.2	Struktura e tarifës së energjisë elektrike sipas divizioneve	42
5.3	Parimi i vendosjes së tarifave sipas grupeve të konsumatorëve.....	43
6	SEKTORI I NGROHJES QENDRORE	46
6.1	Pasqyrë e sektorit të ngrohjes qendrore	46
6.2	Karakteristikat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore.....	46
6.2.1	Impiantet e gjenerimit	46
6.2.2	Sistemet e shpërndarjes.....	46
6.3	Performansa e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore.....	47
6.3.1	Konsumi i lëndës djegëse dhe çmimi.....	47
6.3.2	Gjenerimi, humbjet në sistem dhe furnizimi me ngrohje qendrore.....	49
6.3.3	Sipërfaqja e shërbimit me ngrohje.....	50
6.3.4	Faturimi dhe arkëtimi.....	50
6.4	Tarifat e ngrohjes qendrore për sezonin 2010/2011	51
7	PËRKUJDESJA PËR KONSUMATORË DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE.....	53
7.1	Ankesat dhe aktivitetet në zgjidhjen e kontesteve	53
8	PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË KOSOVË	55
9	AKTIVITETETI NDËRKOMBËTAR I ZRRE-SË	58
9.1	ZRRE-ja dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore	58
9.2	Aktivitetet e BRRKE gjatë vitit 2010	59
9.3	Asociacioni i Rregullatorëve Rajonalë për Energji (ARRE).....	61
9.4	Partneriteti ndërmjet Zyrës së rregullatorit për energji dhe Komisionit Komercial të Illinois-it (ICC), SHBA	62

SHKURTESAT

AIB	Association of Issuing Bodies (Asociacioni i Autoriteteve Certifikuese)
ATR	Autotransformator
BB	Banka Botërore
BETSEE	Balance Energy Tool for South East Europe (Mekanizmi i balancimit të energjisë për Evropën Juglindore)
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
BRR	Bordi Rregullativ
BRRKE	Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë
DTÇ	Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve
DLL	Departamenti Ligjor dhe i Licencimit
DMK	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
ECLO	European Commission Liaison Office (Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian)
EJL	Evropa Juglindore
ENTSO-E	European Network of Transmission System Operators for Electricity (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike)
ERRA	Energy Regulators Regional Association (Asociacioni i Rregullatorëve Rajonalë për Energji)
FEST	Furnizimi me Energji dhe Strukturë Tregu
GPG	Grupi Punues për Gaz
GTE	Gas Transmission Europe (Transmisioni i Gazit Evropian)
GWh	Gigavatorë
HC	Hidrocentral
ICC	Illinois Commerce Commission (Komisioni i Tregtisë i Illinoisit)
ITC	Inter TSO Compensation (Kompensimi ndërmjet OST-ve)
KE	Komuniteti i Energjisë
KEEJL	Komuniteti i Energjisë në Evropën Juglindore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau (Banka kreditore për rindërtim)
KPLK	Komiteti Punues për Licencim dhe Konkurrencë
km	Kilometër
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
kV	Kilovolt
kVA	Kilovoltamper
kW	Kilovat
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MVA	Megavoltamper
MW	Megavat
MW _t	Megavat termik
MWh	Megavatorë
NARUC	National Association of Regulatory Utility Commissioners (Asociacioni Nacional i Komisionerëve të ndërmarrjeve Rregullative)
NQ	Ngrohje Qendrore
NS	Nënstacioni
NjPNQ	Njësia Punuese e Ngrohjes Qendrore
OSSH	Operator i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operator i Sistemit të Transmisionit
OT	Operator Tregu
RTK	Radio Televizioni i Kosovës



SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition (Kontrolli Mbikëqyrës dhe Pranimi i të dhënave)
Sh.A	Shoqëri aksionare
TC	Termocentral
TF	Task Force
TI	Teknologji Informative
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TKEEJL	Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore
UNMIK	United Nation Mission in Kosovo (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
USAID	United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar)
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji

1. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ZYRËN E RREGULLATORIT PËR ENERGJI

1.1 Mandati i zyrës së rregullatorit për energji

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është agjenci e pavarur, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, të cilat përfshijnë: krijimin dhe funksionimin efikas, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese; monitorimin dhe përkujdesen për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; vendosjen e tarifave për aktivitetet e energjisë në mënyrë të arsyeshme dhe në bazë të metodologjisë tarifore; monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës dominuese dhe praktikave jo-konkurruese nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë.

1.2 Struktura organizative e ZRRE-së

ZRRE udhëhiqet nga Bordi, dhe në përbërjen e saj ka katër (4) departamente, grupin teknik këshillëdhënës dhe administratën.

1.2.1 Bordi

Bordi i ZRRE-së përbëhet nga pesë (5) anëtarë, përfshirë kryesuesin e Bordit, i cili njëkohësisht është edhe udhëheqës i ZRRE-së. Anëtarët e Bordit, përfshirë kryesuesin propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2010 Bordi i ZRRE-së ka funksionuar me katër (4) anëtarë meqenëse në shkurt të vitit 2010, një anëtar i Bordit i ka skaduar mandati, për të cilën ZRRE-ja e ka njoftuar me kohë Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës.

Kryesuesi i Bordit për aktivitetet e ZRRE-së dhe për zhvillimet në sektorin e energjisë, i raporton Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve funksionale të tij, sipas kërkesës së tyre. Kryesuesi i ZRRE-së, çdo vit i dërgon Kuvendit raportin vjetor, jo më vonë se tre (3) muaj pas mbylljes së vitit kalendarik. Bordi i ZRRE-së i përmbush detyrat e tij në përputhje me përgjegjësitë që i janë dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë; organizon dhe mbikëqyrë aktivitetet e ZRRE-së, miraton politikat rregullative dhe operacionale, mbikëqyrë përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, dhe menaxhimin financiar të ZRRE-së, miraton nivelin e kompensimit dhe kushtet e punësimit, emëron dhe mbikëqyrë punën e personelit.

Bordi duhet të mbajë të paktën dhjetë (10) seanca në vit, të cilat janë të hapura për publikun dhe paralajmërohen pesë (5) ditë para mbajtjes së tyre, me publikimin e rendit të ditës në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Aktivitetet e bordit të ZRRE-së

Gjatë viti 2010 Bordi ka mbajtur dhjetë (10) seanca, në të cilat ka shqyrtuar çështje të ndryshme në rregullimin e sektorit të energjisë dhe ka marrë 108 vendime, të bëra publike në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së që mund të klasifikohen në:

• Miratimi i Tarifave	4
• Aprovimi i Kodeve	3
• Aprovimi i Rregullave, Metodologjive dhe Procedurave	9
• Aprovimi i Licencave dhe autorizimeve	11
• Aprovimi i MBE	3

- Aprovimi i Derogimeve të neneve të licencave dhe kodeve 12
- Aprovimi i Ankesave të konsumatorëve të shqyrtuara nga Bordi 60
- Tjera 6

Anëtarët e Bordit kanë bashkëpunuar dhe kanë marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e rëndësishme që janë zhvilluar në sektorin e energjisë në Kosovë dhe në rajon.

Gjatë vitit 2010 Bordi ka qenë tërësisht funksional dhe ka përmbushur detyrat dhe obligimet e tij sipas mandatit ligjor.

1.2.2 Departamenti ligjor dhe i licencimit

Departamenti ligjor dhe i licencimit është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dytësor dhe akteve nënligjore, vlerësimin e aplikacioneve për licencim të ndërmarrjeve të energjisë, vlerësimin e aplikacioneve për dhënien e autorizimeve për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, si dhe ofron këshilla ligjore për sektorin e energjisë. DLL gjithashtu bënë mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve.

1.2.3 Departamenti për furnizim me energji dhe strukturë të tregut

Departamenti për furnizim me energji dhe strukturë të tregut është përgjegjës për strukturën e tregut, monitorimin e palëve të tregut, vlerësimin dhe analizën e të dhënave në sektorin e energjisë elektrike. Departamenti gjithashtu monitoron konkurrencën dhe sjelljen e pjesëmarrësve në treg në principet e objektivitetit, transparencës dhe jo-diskriminimit.

1.2.4 Departamenti i tarifave dhe çmimeve

Departamenti i tarifave dhe çmimeve analizon aplikacionet tarifore të ndërmarrjeve të licencuara dhe i përcjell ato te bordi për aprovim, monitoron realizimin e shpenzimeve operative dhe kapitale përmes Shqyrtimeve Tarifore, ndërmerr të gjitha masat që tarifatat të jenë të arsyeshme, jo-diskriminuese, të bazuara në kritere objektive, si dhe të vendosura në mënyrë transparente duke marrë në konsideratë që vënie e tarifave të mos dëmtoj konsumatorët.

1.2.5 Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve është përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve për energji, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi, ky departament bashkëpunon me të gjitha institucionet dhe organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët.

1.2.6 Grupi teknik këshillëdhënës

Grupi teknik këshillëdhënës përbëhet nga ekspertë të sektorit të energjisë që kanë për detyrë ofrimin e këshillave teknike Bordit dhe Departamenteve të ZRRE-së në përmbushjen e funksioneve të tyre.

1.2.7 Zyra administrative

Zyra Administrative është përgjegjëse për ofrimin e përkrahjes administrative Bordit dhe Departamenteve të ZRRE-së, për përmbushjen sa më efikase të detyrave të tyre.




Fig.1.1 Skema organizative e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

1.3 Ngritja e kapaciteteve të ZRRE-së – projektet e asistencës teknike trajnimet dhe punëtoritë

ZRRE në përbërje të saj ka personel profesional, përgatitja e të cilëve u përgjigjet kërkesave të vendeve të punës. Pavarësisht nga kjo, ZRRE angazhohet vazhdimisht të rrisë potencialin e personelit nëpërmjet trajnimeve të ndryshme për arritjen e objektivave të ZRRE-së.

1.3.1. Projektet e asistencës teknike

ZRRE me qëllim të zhvillimit dhe kompletimit të mëtejshëm të legjislacionit dytësor, në zbatimin efikas të procedurave rregullative dhe në përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga ligjet e sektorit të energjisë së Kosovës, si dhe nga obligimet e TKE të EJT është përkrahur me projektin

“Asistencë Zyrës së Rregullatorit për Energji”, financuar dhe administruar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Projekti ka filluar në nëntor të vitit 2008, dhe ka vazhduar edhe gjatë viteve 2009 dhe 2010. Projekti është implementuar nga konsorciumi i kompanive konsulente ndërkombëtare LDK Consultants - ECA-Planet.

Po ashtu ZRRE është përkrahur edhe me këto projekte:

“Konsulencë për të asistuar në privatizimin e distribucionit dhe furnizimit të KEK-ut”, i financuar nga USAID dhe zbatuar nga “Advanced Engineering Associates International Inc” (AEAI). Ky është një program dyvjeçar i asistencës, që ka filluar shtator 2009, për të mundësuar realizimin e suksesshëm të transaksioneve të ndërlidhura me privatizimin e rrjetit të shpërndarjes dhe të furnizimit të KEK-ut, përmes këshillëdhënies palëve të përfshira në sektorin e energjisë në Kosovë. Njëra nga dy komponentët e projektit i dedikohet ZRRE-së, për ta asistuar në plotësimin, qartësimin ose zhvillimin sipas nevojës të legjislacionin përkatës, në mënyrë që detyrat specifike të ZRRE të ndërlidhura me transaksionet përkatëse të mbështesin në mënyrë efikase procesin e privatizimit të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut. Kjo komponentë do përfshijë edhe implementimin në fazën e mëvonshme të post-privatizimit.

“Përmirësimi i ngrohjes qendrore faza 2, kogjenerimi – komponenti i projektit për ZRRE-në: Masat rregullative dhe ligjore për kogjenerimin” në vlerë prej 75,040 €, financuar nga KfW dhe Komisioni Evropian. Një pjesë e këtij projekti i jep mbështetje ZRRE-s në kompletimin e legjislacionit dytësor në lëmin e kogjenerimit.

ZRRE me qëllim të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit në punë ka financuar projektin:

“Zhvillimi i sistemit të menaxhimit elektronik të dokumentacionit dhe informatave për ZRRE-në”. Ky projekt ka filluar të zhvillohet/hartohet në shtator të vitit 2009 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2010.

1.3.2 Trajnimet dhe punëtoritë

Personeli i ZRRE-së gjatë vitit 2010 ka vijuar dhe përfunduar me sukses trajnime të cilat janë renditur në mënyrë kronologjike:

- 01-05 shkurt 2010 - trajnimi mbi “Tregun e energjisë elektrike”, organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (ERRA), mbajtur në Budapest, Hungari;
- 27-30 maj 2010 - trajnimi mbi “Buxhetin, decentralizimin e shpenzimeve dhe menaxhimi i financave publike”, mbajtur në Durrës, Shqipëri;
- 15-16 qershor 2010 - punëtori për “Statistikat e energjisë”, organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, mbajtur në Vjenë, Austri;
- 16-18 qershor 2010 – Seminar për “Komisionerët e rinjë” organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë (ERRA), mbajtur në Stamboll, Turqi;
- 12-16 korrik 2010 - trajnim (shkollë verore) mbi “Rregullimin e sektorit të energjisë”, organizuar ERRA, mbajtur në Budapest, Hungari;
- 1 tetor 2010 - punëtori për “Energji të ripërtëritshme”, organizuar nga Association of Issuing Bodies (AIB) në bashkëpunim me Operatorin e tregut të energjisë së Kroacisë (HROTE), mbajtur në Dubrovnik, Kroaci.

1.4 Komunikimi me publikun

Marrëdhëniet me publikun edhe gjatë vitit 2010 ishin një nga prioritetet e ZRRE-së. Për të gjitha aktivitetet e saj, ZRRE- ka informuar në mënyrë të rregullt dhe transparente të gjitha palët e interesit dhe publikun e gjerë.

Ueb faqja zyrtare e ZRRE-së ka vazhduar të mbetet burim i informatave për çështjet e rregullimit të sektorit të energjisë në Kosovë, për të gjitha palët e interesuara përfshirë edhe mediat. Vazhdimisht është bërë rifreskimi i të dhënave me: publikimin e njoftimeve për takimet e Bordit, vendimet e nxjerra nga Bordi, rregullat, udhëzimet dhe procedurat që rregullojnë sektorin e energjisë, tarifat e energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore, licencat e lëshuara ndërmarrjeve të energjisë, autorizimet për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë, raportet mujore dhe vjetore që paraqesin të gjitha aktivitetet e ZRRE-së etj.

ZRRE ka përcjellë me kujdes të gjitha raportimet e mediave për sektorin e energjisë, si dhe është përgjigjur në pyetjet e gazetarëve për çështje të ndryshme të rregullimit në sektorin e energjisë. Në përgjithësi mediat i kanë kushtuar hapësirë të konsiderueshme sektorit të energjisë, si dhe aktiviteteve të ZRRE-së. Sa i përket raportimeve për ZRRE-në informatat e mediave kanë qenë kryesisht korrekte dhe të paanshme.

2. RAPORTI FINANCIAR

Zyra e Rregullatorit për Energji financohet nga të hyrat vetanake, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, kreu IV, përkatësisht nga taksat që mbliidhen nga ndërmarrjet dhe operatorët e licencuar në sektorin e energjisë.

2.1 Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të Zyrës së Rregullatorit për Energji janë depozituar në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare bankare të ZRRE-së të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2010, Zyra e Rregullatorit për Energji ka realizuar të hyra në shumë prej 550,142.09 €. Duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, ZRRE nga të hyrat e pashpenzuara të vitit 2009, ka bartur në vitin 2010 shumën prej 411,929.44 €. Shuma totale e të hyrave të realizuara dhe të bartura për vitin 2010 është 962,071.53 €, gjegjësisht 105,105.53 € më shumë se sa buxheti i ZRRE-së për vitin 2010. Me qëllim të harmonizimit të Të Hyrave me Buxhetin, Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur më 30 prill 2010, ka marrë vendim që, për periudhën kohore prill - tetor 2010, të licencuarit të lirohen nga obligimi i pagesës së taksës vjetore për shërbimet e ZRRE-së. Kështu për këtë periudhë të licencuarit janë liruar nga pagesa e taksës në një shumë të përgjithshme prej 667,039.12 €. Kjo shumë e mjetëve do të merret parasysh gjatë bashkërenditjes dhe përcaktimit të Të Hyrave të Lejuara për ndërmarrjet e energjisë për vitin 2011 dhe do të reflektohet në tarifat e konsumatorëve të rregulluar.

Tab.2.1 Të hyrat

Përshkrimi	Të hyrat
Të hyrat vetanake 2010	550,142.09
Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2009	411,929.44
Gjithsej të hyrat	962,071.53

2.2 Buxheti

Kuvendi i Kosovës me ligjin nr. 03/L-177 - Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, miratoi buxhetin e Zyrës së Rregullatorit për Energji në shumë prej 938,988.00 €, i ndarë në kategoritë kryesore ekonomike si në vijim:

Tab.2.2 Buxheti në fillim të vitit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	397,134.00
Mallra dhe shërbime	299,454.00
Shpenzime komunale	12,000.00
Shpenzime kapitale	230,400.00

Buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 9,475.00€, me vendimin Nr. 03-V-237 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkurtimin e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve të të gjitha Organizatat Buxhetore linearisht për 3.16 %, me qëllim të financimit të RTK-së. Po ashtu në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në tremujorin e fundit, MEF duke u bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 Nr. 03/ L-218, ka bërë shkurtimin e buxhetit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për 72,547.00 €. Pas këtyre shkurtimeve, buxheti i ZRRE-së ndryshon, si në strukturë po ashtu edhe në shumën e përgjithshme të tij.

Tab.2.3 Buxheti në fund të vitit

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	397,134.00
Mallra dhe shërbime	299,454.00
Shpenzime komunale	12,000.00
Shpenzime kapitale	157,853.00

2.2.1 Shpenzimet buxhetore

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2010, ZRRE ka shpenzuar 651,753.22 €, prej tyre 392,552.06 € nga të hyrat vetanake të vitit 2010, ndërsa 259,201.16 € nga të hyrat e bartura nga viti 2009.

Sipas klasifikimit ekonomik, shpenzimet e ZRRE-së janë si vijon:

Tab.2.4 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe mëditje	332,681.19
Mallra dhe shërbime	187,010.92
Shpenzime komunale	8,271.48
Shpenzime kapitale	123,789.63
Totali	651,753.22

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2010 është 76.05%.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën 2.5

Tab.2.5 Realizimi i buxhetit i shprehur në përqindje

Përshkrimi	Të buxhetuara	Të realizuara	Ndryshimi	Realizimi në %
Paga dhe mëditje	397,134.00	332,681.19	64,452.81	83.77
Mallra dhe shërbime	289,979.00	187,010.92	102,968.08	64.49
Shpenzime komunale	12,000.00	8,271.48	3,728.52	68.93
Shpenzime kapitale	157,853.00	123,789.63	34,063.37	78.42
Totali	856,966.00	651,753.22	205,212.78	76.05

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas nënkategorive kryesore ekonomike.

Tab.2.6 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet	Shuma
Pagat neto	277,632.56
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	23,364.65
Kontributet pensionale të punëdhënësit	15,841.99
Kontributet pensionale të të punësuarve	15,841.99
Gjithsej pagat dhe mëditjet	332,681.19

Tab.2.7 Mallrat dhe shërbimet

Mallrat dhe shërbimet	Shuma
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	9.65
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	20,922.92
Mëditje për udhëtim zyrtar jashtë vendit	5,534.09
Akomodimi për udhëtime zyrtare jashtë vendit	5,288.83
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jashtë vendit	1,584.39
Shpenzime për Internet	2,544.00
Shpenzimet e telefonisë mobile	10,019.90
Shpenzimet postare	418.50
Shërbimet arsimit dhe trajnimit	4,725.00
Shërbime printimi (shtypjeje)	8,589.40
Shërbime të tjera kontraktuese	2,823.48
Shpenzimet për anëtarësim	6,462.50
Mobilje	1,485.00
Telefona	3,383.00
Pajisje të tjera	975.00
Furnizime për zyrë	8,543.86
Furnizim me ushqim dhe pije	2,883.16
Funizime pastrimi	9.00
Naftë për ngrohje qendrore	8,183.23
Karburant për vetura	1,877.92
Provizion Bankar (Raiffeisen Bank)	26.78
Regjistrimi i automjeteve	414.00
Sigurimi i automjeteve	3,390.41
Taksë komunale e regjistrimit të automjeteve	20.00
Sigurimi i ndërtesave	10,458.24
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,048.26
Mirëmbajtja e ndërtesave	8,640.00
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	2,810.00
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	201.20
Qiraja për ndërtesa	52,418.00
Reklamat dhe konkurset	8,073.40
Drekat zyrtare	2,247.80
Gjithsej mallra dhe shërbime	187,010.92

Tab.2.8 Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale	Shuma
Rryma	6,236.74
Uji	442.74
Shpenzimet e telefonit fiks	1,592.00
Gjithsej shpenzime komunale	8,271.48

Tab.2.9 Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale	Shuma
Pajisje të teknologjisë informative	46,017.21
Softuer	27,216.80
Kompjuter	29,120.00
Pasuri e paprekshme	21,435.62
Gjithsej shpenzime kapitale	123,789.63

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2010 ZRRE ka arkëtuar të hyra në vlerë prej 962,071.53 €, që janë më të larta sesa shpenzimet buxhetore të realizuara në vlerë prej 651,753.22 €. Ndryshimi mes të hyrave dhe shpenzimeve në vlerë prej 310,318.31 €, paraqet fondet suficitare që ZRRE ka mbledhur gjatë këtij viti dhe të cilat, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe nenit 64 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, do të barten në vitin 2011.

Tab.2.10 Të hyrat vetanake të bartura

Të hyrat vetjake të bartura në v. 2011	310,318.31
Të hyrat e bartura nga viti 2009	411,929.44
Të hyrat e pranuar gjatë vitit 2010	550,142.09
Gjithsej të hyrat 2010	962,071.53
Shpenzimet për paga dhe mëditje	-332,681.19
Shpenzimet për mallra dhe shërbime	-187,010.92
Shpenzimet komunale	-8,271.48
Shpenzimet kapitale	-123,789.63
Gjithsej shpenzimet 2010	-651,753.22

3. KOMPLETIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE RREGULLATIVE

3.1 Hartimi dhe finalizimi i legjislacionit primar për energji

Në tetor të vitit 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Energji Nr. 03/L-184, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 03/L-201, të cilat kanë hyrë në fuqi dhe zbatohen nga data 01 dhjetor 2010.

Në finalizimin e këtyre Projektligjeve ZRRE ka qenë e angazhuar si me pjesëmarrjen në grupin punues ndërqeveritar, gjithashtu edhe në komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion të Kuvendit të Republikës së Kosovës

- *Ligji për rregullatorin e energjisë Nr. 03/L-185*

Ky ligj rregullon funksionimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji si agjenci e pavarur e Republikës së Kosovës. Ligji përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë: kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, procedurën për dhënien e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregut konkurrues të energjisë si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.

- *Ligji për energjinë elektrike Nr. 03/L-201*

Ky ligj përcakton rregullat e përgjithshme për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, transmissioinit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe qasjes në interkoneksion, organizimin e qasjes ndaj sistemit të transmissioinit dhe sistemit të shpërndarjes, si dhe funksionimin dhe qasjen në tregun e energjisë elektrike në Kosovë.

- *Ligji për energjinë Nr. 03/L-184,*

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen aktivitetet në sektorin e energjisë në Republikën Kosovës me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji për të krijuar kushte të një tregu funksional të energjisë dhe krahas kësaj duke promovuar edhe shfrytëzimin më efikas të energjisë, rritjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimit si dhe përmirësime në mbrojtjen e mjedisit nga veprimtaritë energjetike.

3.2 Hartimi dhe finalizimi i legjislacionit sekondar

Gjate vitit 2010 ZRRE ka hartuar dhe miratuar Rregullat si në vijim:

1. *Doracaku i raportimit për sektorin e energjisë*

Qëllimi i këtij Doracaku është që të udhëzojë të Licencuarin mbi veprimet që duhet ndërmarrë në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me obligimet dhe kushtet e Licencës, si dhe jep shpjegime se si i licencuari t'i organizojë disa nga aktivitetet e tij brenda ndërmarrjes, në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri apo të sigurojë pajtueshmëri të plotë me obligimet që dalin nga licenca.

2. *Rregulla për krijimin e sistemit të Certifikatave të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, mbeturinat si dhe nga bashkëprodhimi i kombinuar me nxehtësinë, në një njësi të vetme gjeneruese*

Qëllimi i kësaj Rregulle është që të përcaktojë kriteret e vendosjes, operimit dhe të mirëmbajtjes së një sistemi për lëshimin, transferimin, rimarrjen dhe revokimin/anulimin e

Certifikatave të Origjinës, që i referohen energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, mbeturinat dhe kogjenerimi.

3. *Rregulla për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe procedurat për pranim në skemën mbështetëse*

Rregulla ka për qëllim përkrahjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, në mënyrë që të arrihen caqet indikative për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të Energjisë, të përcaktuara nga Ministria e Energjisë dhe Minierave.

Miratimi i Rregullave për Certifikata të Origjinës dhe Skemën mbështetëse të cekura më lartë është i një rëndësie të posaçme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë. Me miratimin e tyre mund të konstatohet se është kompletuar korniza rregullative për burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Miratimit të rregullave i ka paraprirë periudha e konsultimit publik gjatë së cilës janë informuar të gjitha palët e interesit në Sektorin e energjisë si dhe iu është dhënë mundësia e dërgimit të vërejtjeve dhe komenteve në këto projekt rregulla. Projekt rregullat pastaj i janë nënshtruar prezantimit publik dhe në fund janë miratuar nga Bordi i ZRRE-së, në seancë publike.

3.3 Autorizimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga BRE

3.3.1 Korniza ligjore

Aktivitetet i rëndësishëm i ZRRE-së konsiderohet edhe lëshimi i Autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, sipas Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte, të bazuar në nenin 38.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

ZRRE edhe gjatë këtij viti ka pranuar Aplikacione/kërkesa nga investitorë potencialë për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. ZRRE ka lëshuar njoftime për autorizime preliminare si dhe autorizime përfundimtare, si në vijim:

a. *Lëshimi i njoftimit për autorizimin preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE*

ZRRE ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet/kërkesat e pranuar për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, në përputhje me Ligjet për sektorin e energjisë dhe rregullat përkatëse, dhe ka siguruar se aplikacionet e tilla janë shqyrtuar në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese. Gjatë shqyrtimit të këtyre aplikacioneve, ZRRE ka marrë për bazë kriteret relevante që duhet të sigurohen nga aplikuesit sipas Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, rrjetave të gazit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte.

ZRRE ka përcaktuar se aplikuesit i kanë përmbushur kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në procedurë për marrjen e njoftimeve për autorizimin preliminar, dhe këto ndërmarrje janë paraqitur në tabelën 3.1.

Tab.3.1 Ndërmarrjet të cilave iu është lëshuar Njoftimi për Autorizim Preliminar

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit	Kapaciteti i instaluar	Lokacioni	Data e lëshimit
1	"Windparkcompany" (KTW) sh.p.k.	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA	100MW	KK Shtime, Republika e Kosovës	V_241_2010 24 mars 2010
2	"Wind Power" SH.A	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA	900kW	Bostan, KK Novobërdë, Republika e Kosovës	V_248_2010 24 qershor 2010
3	"Kelkos-Energy" sh.p.k.	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhimin e energjisë elektrike nga UJI	23MW	Lumëbardhi II, Belaja dhe Deçani, KK Deçan, Republika e Kosovës	V_296_2010 11 nëntor 2010

Ndërmarrjet të cilave iu është lëshuar autorizimi preliminar mund të pajisen me autorizim përfundimtar, nëse plotësojnë kushtet e parapara në rregullën mbi procedurën e autorizimit.

b. Lëshimi i autorizimit

ZRRE pas lëshimit të njoftimit për vendimin preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në procedurën e autorizimit ka pranuar aplikacione/kërkesa për shndërrimin e njoftimit mbi vendimin preliminar në autorizim përfundimtar. Në vazhdim është paraqitur ndërmarrja të cilës i është lëshuar autorizimi përfundimtar.

Tab.3.2 Ndërmarrja së cilës i është lëshuar Autorizimi

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit	Numri i licencës	Lokacioni	Data e lëshimit
1	"Wind Power" SH.A	Ndërtimi i gjeneratorit për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA	900kW	Bostan, KK Novobërdë, Republika e Kosovës	V_299_2010 11 nëntor 2010

3.4 Licencimi i ndërmarrjeve të energjisë

Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për rregullatorin e energjisë, dhe në përputhje me Rregullën mbi licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, ka licencuar aktivitetet për:

- Gjenerim të energjisë elektrike
- Gjenerim të ngrohjes qendrore
- Furnizim publik me energji elektrike
- Furnizim publik me ngrohje qendrore
- Shpërndarje të energjisë elektrike
- Shpërndarje të ngrohjes qendrore
- Operator të sistemit të transmisionit
- Operator të tregut
- Furnizim/tregti të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2010 ka lëshuar Licenca për:

- Furnizim/tregti me energji elektrike

Tab.3.3 Ndërmarrjet e licencuara gjatë vitit 2010

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	ALPIQ ENERGIJA DOO BEOGRAD	Furnizim/tregti me energji elektrike	ZRRE/Li_33/09	Bulevar Zorana Djindjica 64 A, Belgrade, Serbi	05.08.2010 deri 05.08.2012
2	Repower Trading Česká republika s.r.o	Furnizim/tregti me energji elektrike	ZRRE/Li_35/10	Vodičkova 710/31, 11000 Pragë 1, Republika e Çekisë	26.11.2010 deri 26.11.2012

Ndërmarrjet të cilat kanë qenë të licencuara në ZRRE, dhe që gjatë vitit 2010 u ka skaduar afati i licencimit për të kryer aktivitetin e furnizim/tregtisë me energji elektrike, kanë aplikuar për vazhdim licence dhe pas përmbushjes së kushteve iu është vazhduar licenca.

Tab.3.4 Ndërmarrjet të cilave u është vazhduar licenca gjatë vitit 2010

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Përshkrimi i aktivitetit të licencuar	Numri i licencës	Adresa, selia e të licencuarit	Vlefshmëria e licencës
1	"ENERGY FINANCING TEAM" AG ("EFT")	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_01/06	Pestalozzistrasse 2, CH-9000 St. Gallen Zvicër	04.10.2010 deri 04.10.2012
2	"Korporata Energjetike e Kosovës" (KEK) SH.A	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_08/06	"Nëna Terezë" Nr 36, Prishtinë Republika e Kosovës	04.10.2010 deri 04.10.2012
3	"EZPADA S.R.O"	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_13/06	Jungmanova 24, Pragë 1, Republika e Çekisë	04.10.2010 deri 04.10.2012
4	"ČEZ"	Furnizim/tregti me energji elektrike	ERO/Li_20/06	Duhova 1444/2, 14053 Prague 4, Republika e Çekisë	30.10.2010 deri 30.10.2012
5	"KORLEA INVEST A.S"	Furnizim/tregti me energji elektrike		Jesenského 25, 040 01 Košice, Republika e Sllovakisë	14.01.2010 deri 14.01.2012

3.5 Monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë

Bazuar në nenin 14 të ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ndër përgjegjësitë e ZRRE-së është edhe monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë që kryejnë aktivitete të licencuara, në pajtim me obligimet e dhëna me licencë, kodet teknike dhe legjislacionin në fuqi.

Dokumenti *"Doracaku i Raportimit"* parasheh mënyrën dhe afatet e raportimit për ndërmarrjet e licencuara. Në pajtim me këtë, ZRRE ka pranuar raporte tremujore dhe vjetore nga të licencuarit për: prodhim, transmision, operim të tregut, shpërndarje, furnizim publik dhe furnizim/tregti me energji elektrike; prodhim, shpërndarje dhe furnizim publik me ngrohje qendrore.

Megenëse disa nga licencat e lëshuara nga ZRRE janë dhënë me kushte, atëherë ZRRE ka lejuar shtyrje afati (derogim) për disa nene të licencave të cilat nuk kanë mundur të përmbushen nga të licencuarit. Derogimet e lejuara janë bërë me kërkesë të të licencuarve, dhe me një arsyetim bindës për pamundësinë e përmbushje të atyre kushteve. Gjatë këtij viti kërkesat për derogime kanë qenë më të pakta në krahasim me vitet paraprake, pasi që disa nga kushtet e licencave janë përmbushur nga të licencuarit.

3.6 Dokumentet e hartuara nga të licencuarit

Dokumentet në vijim janë hartuar nga ndërmarrjet e licencuara dhe janë aprovuar nga Bordi i ZRRE-së:

- Procedura për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike për NQ Termokos;
- Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019, KOSTT;
- Marrëveshja për blerje të energjisë elektrike të Hidrocentralit Dikanc, KEK – Frigo Food Energy Invest;
- Marrëveshja për blerje të energjisë elektrike të Hidrocentralit Radavc, KEK – Triangle General Contractors;
- Marrëveshja për blerje të energjisë elektrike të Hidrocentralit Burim, KEK - Triangle General Contractors;
- Metodologjia e taksave për kyçje në rrjetin e transmisionit të KOSTT;
- Standardet e Cilësisë të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike – KEK;
- Standardet e cilësisë të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për Operatorin e Sistemit të Transmisionit të KOSTT;
- Standardet e cilësisë të furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH – KEK;
- Kodi për stacionet gjeneruese të energjisë me erë, KOSTT;

4 SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Konsumi i energjisë, në veçanti i energjisë elektrike, është një ndër përcaktuesit e zhvillimit ekonomik të një vendi. Vendet që plotësojnë nevojat e konsumit me prodhim vendor, kanë një bazë të mirë për zhvillim ekonomik. Kosova ka parakushte të mira për prodhim të energjisë elektrike, jo vetëm për plotësimin e nevojave të veta, por edhe për eksport. Sistemi elektroenergetik i Kosovës është i konceptuar për prodhimin e energjisë bazë, të bazuar linjit. Balancimi i sistemit kërkon që të përcillet ndryshimi i konsumit në baza ditore dhe sezonale përmes prodhimit dhe importit. Nëse kjo nuk arrihet atëherë zbatohen reduktimet e konsumatorëve.

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë edhe gjatë vitit 2010 është karakterizuar me prodhim të pa mjaftueshëm të energjisë elektrike, me furnizim jo cilësor dhe me humbje të larta teknike e komerciale.

Për prodhimin e energjisë elektrike ZRRE i ka licencuar TC Kosova A dhe TC Kosova B, që janë në kuadër të KEK-ut, dhe hidrocentralet HC Ujmani dhe HC Lumbardhi.

Nga viti 2010 në operim janë centralet me erë në Golesh, si dhe hidrocentralet e vogla HC Dikance dhe HC Radavc.

Mungesa e investimeve për një kohë të gjatë në rrjetin e transmissiionit dhe shpërndarjes ka shkaktuar ngufatje (fyte të ngushta), dhe furnizim jo cilësor në shumë pjesë të rrjetit. Në vitet e fundit janë bërë investime të cilat kanë përmirësuar dukshëm funksionimin e sistemit elektroenergetik, posaçërisht të rrjetit të transmissiionit.

Për operim, mirëmbajtje dhe siguri të furnizimit me energji elektrike në territorin e Kosovës janë të licencuar Operatori i Sistemit të Transmissiionit dhe Tregut (në KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (në KEK).

Gjithashtu ZRRE ka licencuar edhe Furnizuesin publik (KEK) që është përgjegjës për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike në tërë territorin e Kosovës.

4.1 Rrjeti i transmissiionit

Interkoneksioni i rrjetit të transmissiionit të Kosovës me rajonin dhe Evropën realizohet kryesisht me linja në nivelin e tensionit 400 kV. Kosova me vendet fqinje gjithashtu lidhet edhe me linja 220 kV dhe 110kV. Kosova ka një rrjet të fortë interkonektive që do të përforcohet edhe më tepër me ndërtimin e linjës 400kV Kosovë B – Kashar (Tiranë).

Viteve të fundit është investuar shumë në ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve në rrjetin e transmissiionit. Në vazhdim është paraqitur rrjedha e projekteve kapitale;

1. Projektet e filluara në vitet e mëparshme e që kanë përfunduar në vitin 2010:

- Instalimi i transformatorit ATR3 150 MVA në NS 220/110kV, Prishtina 4
- Rehabilitimi i NS 220/110kV, Kosova A
- Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë në anën 220kV në NS 400/220kV, Kosova B
- Ndërrimi i përçuesve në linjën L212 NS Ferizaj – NS Kosova A (Shndërrimi i kësaj linje nga niveli 220kV në 110kV)

2. Projektet e filluara në vitet e mëparshme që kanë vazhduar në vitin 2010 dhe më tutje:

- SCADA/EMS dhe Telekomunikacion & shërbimet konsulente
- Projekti për implementimin e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri

- Paket Projekti 400/110 kV, Ferizaj 2
- Ndërrimi i përçuesve në linjën 110kV, NS Peja 1 – NS Peja 2

3. Projektet e filluara në vitin 2010 dhe që vazhdojnë tutje:

- Revitalizimi i pajisjeve të tensionit të lartë dhe instalimi i transformatorit ATR3 150 MVA në NS 220/110kV, Prizreni 2
- Sistemi i TI-së për Operatorin e Tregut.

Kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmisionit janë paraqitur në tabelat e mëposhtme, sipas nivelit të tensionit.

Tab.4.1. Të dhënat bazë për nënstacionet në transmision

Tensioni (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1,200
400/110	KOSTT	1	1	300
220/110	KOSTT	3	8	1,200
220/35	Alferon	1	2	320

Tab.4.2. Të dhënat bazë për linjat në transmision

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	181.81
220	KOSTT	231.88
110	KOSTT	727.60

Kosova gjendet në pozitë të volitshme si nyje e fuqishme rajonale, dhe nëpër rrjetin e saj transmetues ka rrjedha të konsiderueshme të energjisë elektrike, duke lidhur veriun e rajonit i cili ka kapacitete të shumta prodhuese, me jugun që ka mungesë të energjisë elektrike.

Këto rrjedha janë paraqitur në figurën e mëposhtme për secilën linjë interkonektive (ndërlidhëse) të Kosovës, në të dyja drejtimet.




Fig.4.1. Rrjedhat e energjisë nëpër linjat ndërlidhëse

Kosova është vend me transit të lartë të energjisë elektrike, me një raport deri 50% të transimit ndaj konsumit (çelësi i transimit). Kjo forcon pozicionin e sistemit transmetues, por njëkohësisht rrit humbjet në transimion dhe ndikon në ngufatjen e rrjetit. Për të menaxhuar transimin rajonal është krijuar mekanizmi për llogaritjen e kompensimit të transimit ndërmjet OST-ve (ITC mekanizmi). Kosova nuk është përfshirë në këtë mekanizëm për shkak të problemeve me Serbinë. Si rrjedhojë, humbjet e shkaktuara nga transiti në Kosovë mbulohen përmes tarifave nga konsumatorët e rregulluar. KOSTT po ashtu është e penguar nga Serbia edhe në alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive.

KOSTT edhe gjatë vitit 2010 është angazhuar që, përmes institucioneve rajonale dhe Evropiane, ta zgjidhë çështjen e transimit dhe alokimit të kapaciteteve. .

Mbingarkimi i rrjetit shkakton rritjen e humbjeve, dhe ndikon në vjetërsimin dhe dëmtimin e pajisjeve si dhe ndërprerjen e furnizimit. Për të vlerësuar ngarkimin e rrjetit të transimionit është e nevojshme analiza e rrjedhave të energjisë nëpër rrjet si dhe e vlerave maksimale të konsumit. Për këto analiza merren pesë (5) vlerat e pikut (ngarkesave maksimale) të realizuara në javë të ndryshme gjatë vitit. Ngarkesa më e lartë, 1158 MWh/h, është regjistruar me 25 janar 2010.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë pesë vlera të pikut për vitin 2010.

Tab.4.3. Pesë vlerat e pikut në vitin 2010

Piku	MW	Data	Dita
I	1,158	25.01.2010	E hënë
II	1,112	31.01.2010	E diel
III	1,091	31.10.2010	E diel
IV	1,088	03.02.2010	E mërkurë
V	1,085	16.12.2010	E enjte

Diagrami ditor i nxjerr si vlerë mesatare për tërë vitin 2010 tregon se prodhimi ditor ka qenë pothuajse konstant, ndërsa konsumi ka ndryshuar në intervale kohore ditë - natë. Në formën e diagramit ditor kanë ndikim edhe reduktimet e realizuara.




Fig.4.2. Diagrami ditor i nxjerrë si mesatare për 24 orë për vitin 2010

Ndryshimi i konsumit në tarifa ditë/natë është mjaftë i lartë. Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur ndryshimi në mes mesatares së maksimumeve dhe minimumeve ditore të konsumit gjatë muajve për vitin 2010.




Fig.4.3. Mesatarja mujore e ngarkesave maksimale dhe minimale

Ndryshimet e prodhimit, konsumit, importit/eksportit dhe reduktimeve të energjisë elektrike mund të vërehen edhe përmes diagrameve orë për orë. Më poshtë janë paraqitur diagramet me këto të dhëna për dy muaj karakteristike (shtator dhe dhjetor).




Fig.4.4. Diagrami mujor i prodhimit, konsumit, totalit dhe reduktimeve për muajin shtator 2010

Në këto diagrame vërehen ndryshmet e konsumit dhe përcjellja e këtyre ndryshimeve përmes prodhimit dhe import/eksportit e ndonjëherë edhe përmes reduktimeve.




Fig.4.5. Diagrami mujor i prodhimit, konsumit, totalit dhe reduktimeve për muajin dhjetor 2010

4.1.1 Humbjet e energjisë elektrike në transmision

Humbjet e energjisë në transmision në vitin 2010 janë dukshëm më të vogla krahasuar me vitin 2009. Këto humbje janë zvogëluar nga 197 GWh (3.31%), sa ishin në vitin 2009, në 131 GWh (2.38%), në vitin 2010. Në shumën totale janë përfshirë edhe humbjet e shkaktuara nga energjia elektrike e tranzituar nëpërmjet rrjetit të transmisionit.

Tab.4.4 Humbjet në transmision të realizuara dhe sipas balancit në vitin 2010

Muajt	Kons. bruto realizim	Kons. bruto balanc	Realiz/Bal	Humbjet në bartje balanc		Humbjet në bartje realizim	
	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Janar	602,947	586,194	102.9	21,645	3.69	15,174	2.52
Shkurt	526,254	529,704	99.3	19,539	3.69	12,386	2.35
Mars	531,520	539,247	98.6	20,708	3.84	12,899	2.43
Prill	432,483	413,377	104.6	15,491	3.75	8,959	2.07
Maj	395,083	382,796	103.2	17,236	4.50	9,217	2.33
Qershor	356,342	350,924	101.5	13,987	3.99	6,932	1.95
Korrik	366,802	358,698	102.3	11,563	3.22	11,034	3.01
Gusht	379,738	356,186	106.6	12,627	3.55	9,535	2.51
Shtator	370,046	362,762	102.0	14,694	4.05	8,800	2.38
Tetor	471,321	449,241	104.9	14,837	3.30	10,319	2.19
Nëntor	484,940	485,992	99.8	15,983	3.29	10,812	2.23
Dhjetor	588,240	583,255	100.9	18,957	3.25	14,977	2.55
Totali	5,505,716	5,398,376	101.99	197,267	3.65	131,043	2.38

Gjatë viteve të fundit vërehet një zvogëlim i vazhdueshëm i humbjeve në transmision që është paraqitur në tabelën më poshtë.

Tab.4.5 Humbjet në transmision 2008-2010

Viti	Konsumi bruto	Humbjet	
	MWh	MWh	%
2008	4,943,714	214,814	4.35
2009	5,275,108	174,573	3.31
2010	5,505,716	131,043	2.38

4.2 Rrjeti i shpërndarjes

Me gjithë investimet e bëra në vitet e fundit, Rrjeti i Shpërndarjes ende nuk është në gjendje të kënaqshme për një furnizim të sigurt dhe cilësor të konsumatorëve me energji elektrike. Rrjeti i shpërndarjes përfshin nënstationet 110/x kV e më poshtë, si dhe linjat e niveleve të tensionit 35kV e më poshtë.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat bazë të linjave sipas gjatësisë së tyre dhe të nënstationeve sipas niveleve të tensionit në sistemin e shpërndarjes.

Tab 4.6. Të dhënat bazë të linjave të OSSH-së

Tensioni (kV/kV)	Pronari	Rrjeti ajror (km)	Rrjeti kabllor (km)	Gjatësia (km)
35	KEK	648.42	26.38	674.80
10(20)	KEK	297.72	184.66	482.39
10	KEK	5,159.76	801.00	5,960.76
6	KEK	44.14	1.58	45.72
0.4	KEK	11,503.78	485.98	11,989.76

Tab.4.7. Numri i nënstacioneve sipas nivelit të tensionit në OSSH

Tensioni (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
220/35/10(20)	KEK	1	1	40.00
220/10(20)	KEK	1	1	40.00
110/35/10(20)	KEK	6	10	312.00
110/35	KEK	7	13	438.00
110/10(20)	KEK	2	4	143.00
110/10	KEK	9	14	472.00
110/35/6.3	Trepça	1	2	63.00
110/35	Trepça	-	2	126.00
110/6.3	Sharri	1	2	40.00
110/35	Ujmani	1	1	20.00
35/10	KEK	52	100	641.80
35/06	Birra Peja	1	1	4.00
35/0.4	KEK	1	1	0.63
(10)20/0.4	KEK/privat	1,117	1,159	318.57
10/0.4	KEK/privat	5,382	5,492	1,521.00
6/0.4	KEK	37	37	7.13

Gjatë vitit 2010 në rrjetin e shpërndarjes janë realizuar këto projekte kapitale:

- rehabilitimi dhe zgjerimi NS 110/35/10 kV Prishtina 1, NS 110/10 kV Prishtina 2, NS 110/10 kV Istogu dhe NS 110/35/10 kV, Shtime;
- ndërtimi i 148.4 km linja në nivelin 10 (20) kV dhe 40.5 km linja në nivelin 0.4 kV.
- ndërtimi i 190 NS 10/0.4 kV me fuqi totale prej 37.8 MVA.

4.2.1 Humbjet në shpërndarje

Humbjet e përgjithshme në shpërndarje janë shumë të larta. Këto humbje ndahen në humbje teknike që shkaktohen në elementet e rrjetit, dhe në humbje komerciale që shkaktohen nga keqpërdorimi i energjisë elektrike.

Në vitin 2010 humbjet e përgjithshme kanë qenë 1,879 GWh (41.22%), ndërsa në vitin 2009 kanë qenë 1,895 GWh (42.80%).

Tab.4.8 Humbjet në shpërndarje sipas distrikteve për vitin 2010

Distriktet	Ngarkimi	Realizimi	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet totale	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
Prishtina	1,392,420	855,885	217,083	15.59	319,453	22.94	536,535	38.53
Mitrovica	619,483	213,422	91,637	14.79	314,424	50.76	406,061	65.55
Peja	521,655	296,876	96,225	18.45	128,554	24.64	224,779	43.09
Gjakova	417,169	251,707	76,340	18.30	89,122	21.36	165,462	39.66
Prizreni	638,532	414,074	135,643	21.24	88,815	13.91	224,459	35.15
Ferizaj	575,067	356,139	108,695	18.90	110,233	19.17	218,928	38.07
Gjilani	394,710	291,610	58,566	14.84	44,534	11.28	103,100	26.12
Total shpërndarja	4,559,037	2,679,713	784,188	17.20	1,095,135	24.02	1,879,324	41.22

Humbjet teknike në vitin 2010 kanë qenë 784 GWh (17.20%), ndërsa humbjet komerciale kanë qenë 1,095 GWh (24.02%) të konsumit në shpërndarje. Sipas Balancit Elektroenergetik 2010 humbjet teknike në përqindje janë parashikuar të jenë 17.49%, ndërsa humbjet komerciale 20% të konsumit në shpërndarje.




Fig.4.6 Humbjet teknike dhe komerciale në shpërndarje në vitin 2010 - krahasimi me vitin 2009 dhe balancin 2010

Bazuar në tabelën 4.9 humbjet teknike në vitin 2010 janë më të vogla për 0.85% se në vitin 2009, ndërsa humbjet komerciale për 0.74 %.

Tab.4.9 Humbjet në shpërndarje për vitet 2008-2010

Vitet	Ngarkimi	Realizimi	Humbjet teknike		Humbjet komerciale		Humbjet totale	
	MWh	MWh	MWh	%	MWh	%	MWh	%
2008	4,132,783	2,363,281	704,769	17.05	1,064,732	25.76	1,769,502	42.82
2009	4,428,053	2,532,626	799,137	18.05	1,096,290	24.76	1,895,427	42.80
2010	4,559,037	2,679,713	784,188	17.20	1,095,135	24.02	1,879,324	41.22

4.3 Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike

Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në nenin 14 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka kompetencë të përcaktojë standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit që duhen përmbushur nga të licencuarit.

Grupi punues i përbërë nga ZRRE, MEM dhe të licencuarit si Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesi Publik, gjatë vitit 2010 ka përgatitur dokumentin për standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike dhe ka propozuar standardet e cilësisë sipas të licencuarve.

ZRRE ka aprovuar standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike për të licencuarit si: Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesi Publik dhe të cilat standarde do të zbatohen nga data 1 janar 2011.

Cilësia e furnizimit dhe e shërbimit të energjisë elektrike përcaktohet nga:

- Kontinuiteti i furnizimit;
- Cilësia e tensionit, dhe
- Cilësia komerciale.

4.3.1 Kontinuiteti i furnizimit

Kontinuiteti i furnizimit është i ndërlidhur me disponueshmërinë e energjisë elektrike, dhe matet me anë të indekseve siç janë:

- Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare në sistem (*ang. System Average Interruption Duration Index - SAIDI*),

- Indeksi i frekuencës së ndërprerjeve mesatare në sistem (ang. *System Average Interruption Frequency Index – SAIFI*), dhe
- Energjia e pafurnizuar (ang. *Energy Not Supplied - ENS*).

Këto indekse paraqiten në baza vjetore dhe për vitin 2010 kanë qenë:

- SAIDI = 95.65 orë për konsumator në vit;
- SAIFI = 38.83 ndërprerje për konsumator në vit; dhe
- ENS = 71.78 GWh.

Indekset e lartpërmendura të cilët duhet t'i përmbushin të licencuarit gjatë vitit 2011, janë:

- SAIDI - nuk do të tejkalojë njëzetë (20) orë ndërprerje të planifikuara për konsumator dhe tridhjetë (30) orë ndërprerje të paplanifikuara ;
- SAIFI - nuk do të tejkalojë pesë (5) ndërprerje të planifikuara për konsumator dhe tetë (8) ndërprerje të paplanifikuara; ndërsa
- ENS – nuk do të tejkalojë tetëmbëdhjetë (18) GWh.

4.3.2 Cilësia e tensionit

Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të energjisë elektrike dhe monitorohet përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit.

Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të furnizimit me energji, në Kodin e Shpërndarjes dhe Kodin e Matjes së shpërndarjes.

4.3.3 Cilësia komerciale

Cilësia komerciale përcakton shpejtësinë dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Standardet e cilësisë komerciale janë të përfshira në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, Rregullën për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe Rregullën mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë në Kosovë.

ZRRE ka filluar përgatitjen e dokumentit mbi monitorimin e performansës së të licencuarve kundrejt përmbushjes së këtyre standardeve. Përmes këtij dokumenti, do të monitorohet përmbushja e standardeve nga të licencuarit.

4.4 Prodhimi dhe konsumi i linjitit

Linjiti paraqet rezervën kryesore si burim primar i energjisë në Republikën e Kosovës. Prodhimi nga linjiti merr pjesë me rreth 97 % të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë. Dy minierat, Bardhi dhe Mirashi, furnizojnë me linjit termocentralet Kosova A dhe Kosova B.

Projekti për Sibovcin Jugperëndimor është vënë në funksion me disa vonesa. Megjithatë eksploatimi i linjitit ka filluar në vitin 2010, dhe janë nxjerrë 360 mijë tonë linjit.

Tab.4.10 Prodhimi dhe konsumi i linjitit 2010

Prodhimi/konsumi i linjitit 2010	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Prodhimi i linjitit (t*1000)	526	613	709	753	641	614	646	764	576	761	609	747	7,958
Konsumi i linjitit (t*1000)	723	720	815	635	673	787	464	575	632	733	668	843	8,269

Prodhimi dhe konsumi i linjitit në vitin 2010 ka pasur një rritje të vogël ndaj vitit 2009. Vlerat në tabelën e mësipërme përmbajnë konsumin e linjitit në KEK, ndërsa konsumi i gjithmbarshëm i linjitit

gjatë vitit 2010 është më i lartë për 193 mijë ton, sasi kjo që është shitur te konsumatorë tjerë. Pra konsumi i gjithmbarshëm i linjitit është 8 462 mijë ton.




Fig.4.7 Prodhiimi dhe konsumi i linjitit në vitet 2008-2010

4.5 Prodhiimi i energjisë elektrike

Dy termocentralet, TC Kosova A dhe TC Kosova B, të cilat përdorin linjitin si lëndë djegëse marrin pjesë me mbi 97% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Kosovë. Në tabelën 4.11 janë të paraqitura të dhënat përkatëse mbi kapacitetin e njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Tab.4.11 Kapacitetet termo gjeneruese

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njësive të TC (MW)			Lënda djegëse	Ton/MW	Futja në operim
	Instaluar	Neto	min/max			
A1	65	Nuk operon		Linjit/naftë		1962
A2	125	Nuk operon		Linjit/naftë		1964
A3	200	182	100-130	Linjit/naftë	1.7-1.9	1970
A4	200	182	100-130	Linjit/naftë	1.7-1.9	1971
A5	210	187	100-135	Linjit/naftë	1.7-1.9	1975
TC Kososva A	800	551				
B1	339	310	180-260	Linjit/mazut	1.40-1.45	1983
B2	339	310	180-260	Linjit/mazut	1.40-1.46	1974
TC Kososva B	678	620				

Përveç termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, të cilat menaxhohen nga KEK-u, në operim janë edhe hidrocentrali Ujmani (2 x 17.5 MW), i menaxhuar nga ndërmarrja publike Ibër-Lepenci, dhe katër hidrocentrale të vogla, të cilat u janë dhënë me koncesion investuesve privatë.

Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2010 ka vazhduar aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Në korrik të vitit 2010 është përgatitur drafti i fundit i kërkesës për propozime dhe dokumente tjera të pakos tenderuese, të cilat iu janë dërguar ofertuesve të para-kualifikuar për komentim. Procesi pritet të vazhdojë dhe të përmbyllet gjatë vitit 2011 me zgjedhjen e ofertuesit të suksesshëm për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese sipas paket projektit Kosova e re.

ZRRE ka qenë pjesëmarrëse në komitetin drejtues dhe në grupin punues, duke dhënë kontributin e saj në përgatitjen e dokumenteve të pakos tenderuese të projektit Kosova e Re.

Në tabelën 4.12 janë paraqitur të dhënat kryesore për hidrocentralet të cilat janë në operim.

Tab.4.12 Kapacitetet hidro gjeneruese

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njësive HC		Futja në operim
	Instaluar	Neto	
HC Ujmani	35.00	32.00	1983
HC Lumbardhi	8.80	8.00	1957 (2006)
HC Dikanci	1.34	1.32	1957 (2010)
HC Radavci	0.28	0.28	1934 (2010)
HC Burimi	0.48	0.47	1948 (2011)
Total HC	45.90	42.07	

Në fillim të vitit 2010 në Golesh, Komuna e Fushë Kosovës, janë lëshuar në operim tri (3) turbinat e para të gjeneratorëve me erë, secila prej tyre me kapacitet të instaluar prej 450 kW, të cilat në total kanë prodhuar 471 MWh.

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike gjatë vitit 2010 ka qenë 5,037 GWh, ndërsa gjatë vitit 2009 ka qenë 4,798 GWh. Ky prodhim është 5% më i lart se në vitin 2009 dhe 6.3% më i lart se prodhimi i parashikuar në balancin elektroenergjetik 2010.




Fig.4.8 Prodhimi i energjisë elektrike 2008-2010

Prodhimi në prag të TC Kosova A gjatë vitit 2010 ka qenë 1,685 GWh, duke tejkaluar parashikimin sipas balancit elektroenergjetik 2010 për 19.5%. TC Kosova B gjatë vitit 2010 ka prodhuar në prag 3,195 GWh, duke realizuar parashikimin bazuar në balancin elektroenergjetik 2010 për 98.7%.

Tab.4.13 Prodhimi i realizuar dhe sipas balancit për vitin 2010

Prodhimi /Njesitë prodhuese	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh
A1	-638	-599	-552	-377	-344	-262	-522	-1,066	-279	-438	-2,901	-3,075	-11,052
A3	33,641	53,023	81,894	35,266	67,344	21,894	38,030	77,431	13,774	90,283	39,191	56,587	608,358
A4	19,052	49,142	51,418	66,434	1,632	73,832	81,704	11,726	71,979	58,214	70,850	47,543	603,525
A5	50,481	41,095	31,518	34,483	2,693	70,762	42,538	64,385	-918	2,464	76,653	67,804	483,958
TC Kososva A	102,536	142,661	164,277	135,806	71,326	166,226	161,750	152,477	84,557	150,522	183,793	168,859	1,684,789
B1	153,674	130,404	150,604	147,232	158,320	139,323	81,890	31,088	162,854	188,648	63,936	172,248	1,580,221
B2	166,361	141,300	162,545	76,131	168,383	153,050	5,367	159,332	170,578	109,519	142,168	160,141	1,614,873
TC Kososva B	320,035	271,703	313,149	223,363	326,702	292,372	87,257	190,420	333,432	298,167	206,104	332,388	3,195,094
HC Ujmani	20,267	9,797	17,847	10,019	7,684	5,625	2,993	3,652	4,507	2,654	7,784	22,631	115,460
Hc Distributive	3,309	1,650	2,599	4,328	6,734	5,335	2,704	1,308	1,044	3,351	4,054	5,634	42,050
Total prodhimi i realizuar	446,148	425,810	497,872	373,515	412,446	469,559	254,703	347,857	423,539	454,694	401,736	529,512	5,037,393
Total prodhimi sipas balancit	440,653	397,642	440,141	344,988	445,960	427,806	200,210	319,605	445,975	412,344	400,091	464,866	4,740,281
Realizim/Bilanc	101%	107%	113%	108%	92%	110%	127%	109%	95%	110%	100%	114%	106%

Prodhimi në TC Kosova A është për 18.3% më i lart se në vitin 2009, ndërsa në TC Kosova B është për 1.7% më i ulët. Dëmtimi i dy rotorëve të shtypjes së ulët në TC Kosova B dhe remontet, kanë ndikuar që prodhimi në vitin 2010 të jetë pak më i ulët se në vitin 2009.



Fig 4.9 Pamje nga Termocentrali Kosova B

Në figurën 4.10 është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e njësive gjeneruese në prodhimin e përgjithshëm sipas muajve, për vitin 2010.




Fig.4.10 Pjesëmarrja në prodhim e njësive gjeneruese sipas muajve në vitin 2010

TC Kosova B ka mbuluar 63% të prodhimit të përgjithshëm, TC Kosova A 33%, ndërsa Hidrocentralet 3%.

4.6 Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike në vitin 2010 është 5,505.7 GWh dhe paraqet një rritje të kërkesës prej 4.4% krahasuar me vitin 2009 kur ka qenë 5,275.1 GWh. Ky konsum krahasuar me balancin elektroenergetik 2010 është për 2% më i lartë.

Në tabelën 4.14 është paraqitur konsumi i përgjithshëm i realizuar në vitin 2010 në raport me konsumin e parashikuar.

Tab.4.14 Konsumi i përgjithshëm në vitin 2010

2010	Konsumi i realizuar	Konsumi sipas balancit	Real./Bala.
	MWh	MWh	%
Janar	602,947	586,194	102.9
Shkurt	526,254	529,704	99.3
Mars	531,520	539,247	98.6
Prill	432,483	413,377	104.6
Maj	395,083	382,796	103.2
Qershor	356,342	350,924	101.5
Korrik	366,802	358,698	102.3
Gusht	379,738	356,186	106.6
Shtator	370,046	362,762	102.0
Tetor	471,321	449,241	104.9
Nëntor	484,940	485,992	99.8
Dhjetor	588,240	583,255	100.9
Totali	5,505,716	5,398,376	102.0

Ndërsa rritja e konsumit gjatë tri (3) viteve të fundit është paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




Fig.4.11 Konsumi i përgjithshëm 2008-2010

Konsumi i energjisë elektrike sipas kategorive të konsumatorëve për vitin 2010 është dhënë në tabelën 4.15. Duhet theksuar se konsumatorët: Ferronikeli, Trepça dhe Sharrcemi janë të kyçur në rrjetin e transmissioinit.

Tab.4.15 Konsumi sipas shpenzuesve dhe humbjet e energjisë

Shpenzuesit - 2010	MWh
Konsumi i përgjithshëm	5,505,716
Humbjet në Transmision	131,043
Ferronikeli	619,645
Trepça & Sharrcemi	80,974
Konsumatorët intern të KEK	115,170
Shpërndarja bruto	4,558,886
Shpërndarja neto	2,679,713
Humbjet në shpërndarje	1,879,173

Një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e konsumit ka pasur edhe rritja e konsumit të Ferronikelit i cili në vitin 2010 ka qenë 619.6 GWh dhe është për 34.6% më i lart se në vitin 2009 (460.4 GWh).

Në figurën 4.12 është paraqitur konsumi sipas kategorive dhe humbjet në transmision dhe shpërndarje.




Fig.4.12 Pjesëmarrja e kategorive të ndryshme në konsumin e përgjithshëm 2010

4.6.1 Konsumi në shpërndarje

Konsumi i përgjithshëm i realizuar në shpërndarje në vitin 2010 ka qenë 4,559 GWh, ndërsa në vitin 2009 ka qenë 4,428 GWh, me një rritje prej 3%. Krahasuar me konsumin e parashikuar në balancin elektroenergetik 2010 ka një rritje prej 5%.

Me gjithë përpjekjet për evitimin e reduktimeve të planifikuara të energjisë elektrike, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar së aplikuari skema ABC e reduktimeve. Krahasuar me vitin 2009 është shënuar një rënie e theksuar e reduktimeve nga 373 GWh në 205 GWh në vitin 2010.




Fig.4.13 Konsumi në shpërndarje 2008-2010

Konsumi më i lartë është realizuar në distriktin e Prishtinës 30.5% ndaj konsumit të përgjithshëm në shpërndarje, ndërsa konsumi më i ulët është në distriktin e Gjilanit me 8.7%. Në tabelën 4.16 është paraqitur konsumi sipas kategorive për secilin distrikt.

Tab.4.16 Konsumi në distrikte sipas kategorive


Distriktet	Amvisëria	Industria	Komercial	Ndr. publik	Total
	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh
Prishtina	546,289	81,503	224,655	3,438	855,885
Mitrovica	161,756	17,083	33,778	806	213,422
Peja	217,617	20,789	57,613	857	296,876
Gjakova	182,080	21,321	47,094	1,213	251,707
Prizreni	287,907	51,623	72,689	1,855	414,074
Ferizaji	253,065	22,952	79,084	1,038	356,139
Gjilani	224,495	11,330	55,041	743	291,610
Total shpërndarja	1,873,209	226,600	569,955	9,949	2,679,713

Në tabelën 4.17 është paraqitur struktura e konsumit të energjisë elektrike sipas kategorive tarifore. Pjesëmarrja e konsumit familjar ndaj konsumit të përgjithshëm të faturuar është 69.9%, që paraqet një ekonomi me zhvillim të ulët industrial. Konsumatorët komercial marrin pjesë me 21.3% të konsumit të përgjithshëm në shpërndarje, konsumatorët industrial të kyçur në shpërndarje me 8.5%, ndërsa ndriçimi publik me 0.4%.

Tab.4.17 Konsumi në shpërndarje sipas kategorive tarifore 2008 - 2010

Konsumi sipas kategorive	2008	2009	2010
	MWh	MWh	MWh
110 kV (transmision: Sharri & Trepça)	84,311	83,627	80,974
35 kV	41,593	38,616	35,755
10 kV	174,246	188,862	190,845
Amvisëria nën 200 kWh/muaj dhe spitalet	503,755	560,908	628,056
Amvisëria (201-600)kWh/muaj	594,346	666,314	750,562
Amvisëria mbi 600 kWh/muaj	479,798	484,578	465,617
0.4 kV I	140,983	177,877	200,572
0.4 kV II	326,122	350,033	369,382
Ndriçimi publik	7,926	8,514	9,949
Amvisëria pa njehsor	77,348	56,923	28,974
Total	2,430,428	2,616,253	2,760,687

Në figurën 4.14 është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e kategorive tarifore në konsumin e përgjithshëm në shpërndarje.


Fig.4.14 Pjesëmarrja e kategorive të konsumit në shpërndarje

4.7 Faturimi dhe arkëtimi

Energjia elektrike e faturuar dhe e arkëtuar në shpërndarje ka shënuar rritje në vitin 2010. Faturimi ka qenë 174,747,496 €, ndërsa arkëtimi 151,805,138 €.

Raporti arkëtim/faturim në shpërndarje për vitin 2010 ka qenë 86.9%, ndërsa në vitin 2009 ka qenë 79.7%.

Tab.4.18 Faturimi dhe arkëtimi në shpërndarje 2008 - 2010

Vitet	Ngarkimi	Realizimi	Faturimi	Arkëtimi	Raporti Ark/Fat
	MWh	MWh	€	€	
2008	4,035,076	2,093,372	165,351,104	118,845,454	71.87%
2009	4,428,053	2,532,626	178,295,723	142,110,110	79.70%
2010	4,559,037	2,679,713	174,747,496	151,805,138	86.87%

Faturimi dhe arkëtimi i konsumatorëve është paraqitur në tabelën 4.19. Përveç konsumatorëve në shpërndarje, në tabelë janë paraqitur edhe konsumatorët tjerë të kyçur në nivelin 110kV dhe Feronikeli si konsumator i kualifikuar, i kyçur në nivelin 220kV.

Tab.4.19 Faturimi dhe arkëtimi në vitin 2010

2010	Ngarkimi	Faturimi	Arkëtimi	Raporti Ark./Fat.
	MWh	€	€	%
Shpërndarja	4,559,037	174,747,496	151,805,138	86.9
110 kV (Sharrceci + Trepça)	80,974	5,606,100	5,606,100	100.0
Feronikeli	619,645	20,961,339	20,961,339	100.0
Totali	5,259,656	201,314,935	178,372,577	88.6

Përqindja e faturimit dhe arkëtitimit ka variacione sipas distrikteve. Kjo është paraqitur në vlera bruto (me TVSH) në tabelën 4.20.

Tab.4.20 Faturimi dhe arkëtimi sipas distrikteve dhe pjesëmarrja e tyre në arkëtimin total

Distriktet	Faturimi (€)	Arkëtimi (€)	Raporti ark/fat (%)	Pjesëmarrja në ark. total (%)
Prishtinë	57,816,935	52,185,777	90.26	34.38
Mitovicë	13,742,949	11,390,583	82.88	7.50
Pejë	19,759,089	17,266,686	87.39	11.37
Gjakovë	15,965,916	14,082,625	88.20	9.28
Prizren	26,412,211	22,762,842	86.18	14.99
Ferizaj	23,007,410	17,825,091	77.48	11.74
Gjilan	18,042,986	16,291,534	90.29	10.73
Totali	174,747,496	151,805,139	86.87	100.00

4.8 Tregu i energjisë elektrike

Modeli ekzistues i tregut në Kosovë bazohet në kontrata bilaterale në mes të palëve. Kohëzgjatja maksimale e kontratave sipas ligjit ka qenë pesë (5) vjet me mundësi të vazhdimit. Me ligjet e reja të sektorit të energjisë të aprovuara në dhjetor 2010 nuk parashihet afati i kohëzgjatjes së kontratave.

Reformimi i sektorit të energjisë, si pjesë e strategjisë së energjisë, kërkon ndryshime edhe në modelin e tregut. Krijimi i një modeli funksional të Tregut është një hap i rëndësishëm drejt konsolidimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë. Ky model duhet të jetë në përputhje me Strategjinë e energjisë për Kosovën 2009-2018, Direktivat Evropiane dhe kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Evropës Juglindore, për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike.

Në kuadër të krijimit të modelit të tregut, me iniciativën e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave është formuar grupi punues ku janë përfshirë përfaqësues të sektorit të energjisë në Kosovë si dhe këshilltarë të transaksioneve për privatizimin e distribucionit dhe furnizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Grupi punues ka mbajtur disa takime gjatë vitit 2010 dhe si rezultat është miratuar “koncept modeli” si orientim për krijimin e modelit final të tregut në Kosovë i cili pritet të përfundojë së shpejti.

4.8.1 Rrjedhat e energjisë elektrike

Si edhe në vitet paraprake, Kosova në vitin 2010 ka qenë neto importuese e energjisë elektrike, me sasi prej 466 GWh. Balanca e energjisë elektrike është paraqitur në figurën e mëposhtme cila përfshin gjenerimin, importin, eksportin, transicionin, shpërndarjen, konsumatorët e rregulluar dhe ata të kualifikuar, si dhe transitin. Rrjedhat e energjisë elektrike në figurë janë dhënë me vlera fizike në GWh.




Fig.4.15. Rrjedhat e energji së elektrike në vitin 2010

4.8.2 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Një pjesë e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë mbulohet nga importi, mirëpo duke pasur parasysh diagramin e konsumit si dhe prodhimin jo fleksibil, gjithashtu është eksportuar një sasi e energjisë elektrike.

Neto importi merr pjesë me 8.46 % në konsumin e përgjithshëm (bruto), ku pjesëmarrja e importit (kontrata + shkëmbim) është 14.86 %, ndërsa e eksportit (kontrata + shkëmbim) është 6.40 %.

Energjia elektrike e importuar gjatë vitit 2010 ka qenë 684,948 MWh me vlerë prej 39,664,332 €, me çmim mesatar prej 57.91 €/MWh, përderisa energjia elektrike e importuar në vitin 2009 ka qenë 610,509 MWh, me çmim mesatar 75.77 €/MWh. Sasia e energjisë elektrike e importuar është rritur për 12.19 % krahasuar me vitin paraprak, ndërsa çmimi mesatar është zvogëluar për 23.57 %.




Fig. 4.16. Importi i energjisë elektrike dhe çmimi në vitin 2010

Sasia e importuar e energjisë elektrike në formë shkëmbimi është 133,439 MWh me koeficient kthimi 1:1 në të njëjtën periudhë dhe tarifë. Nëse e krahasojmë me vitin 2009, atëherë sasia e importuar në formë shkëmbimi ka pësuar një rënie prej 15.03 %.




Fig.4.17. Eksporti i energjisë elektrike dhe çmimi në vitin 2010

Sasia totale e energjisë elektrike të cilën e ka eksportuar KEK-u gjatë këtij viti është 195,220 MWh, me çmim mesatar prej 26.44 €/MWh. Kjo sasi e eksportit KEK-ut i ka sjell të ardhura prej 5,160,831 €.

Nëse këtë e krahasojmë me vitin 2009 rezulton se sasia e eksportuar është rritur për 71.38 %, ndërsa çmimi mesatar për 31.09%.

Çmimi i ultë i energjisë elektrike të eksportuar krahasuar me çmimin e importit është si pasojë se eksporti është realizuar kryesisht në tarifën e ultë ndërsa importi në tarifën e lartë (orët e pikut).

Tab.4.21. Shkëmbimi, importi dhe eksporti i energjisë elektrike për vitin 2010

Muaji	Import			Eksport			Shkëmbim			Total		
	Sasia (MWh)	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)	Sasia (MWh)	Çmimi (€/MWh)	Vlera (€)	Marrje (MWh)	Dhënie (MWh)	Ndrysh. (MWh)	Marrje (MWh)	Dhënie (MWh)	Ndrysh. (MWh)
1	85,840	63.41	5,442,800	0		0	66,020	0	-66,020	151,860	0	-151,860
2	94,050	64.00	6,019,243	0		0	14,425	2,180	-12,245	108,475	2,180	-106,295
3	49,190	55.72	2,740,892	6,415	19.84	127,303	1,870	10,240	8,370	51,060	16,655	-34,405
4	63,389	43.72	2,771,476	20,515	18.15	372,327	17,710	1,500	-16,210	81,099	22,015	-59,084
5	1,519	69.30	105,265	38,735	21.00	813,592	17,386	4,492	-12,894	18,905	43,227	24,322
6	8,260	53.75	443,962	56,085	31.77	1,781,994	0	60,407	60,407	8,260	116,492	108,232
7	120,910	51.45	6,220,240	0		0	0	10,158	10,158	120,910	10,158	-110,752
8	58,995	55.20	3,256,375	0		0	0	18,754	18,754	58,995	18,754	-40,241
9	6,620	70.45	466,356	31,353	26.60	834,012	0	34,137	34,137	6,620	65,490	58,870
10	39,705	60.17	2,389,177	30,595	31.12	952,205	14,548	14,033	-515	54,253	44,628	-9,625
11	95,615	64.09	6,128,361	8,420	24.35	205,040	1,000	1,350	350	96,615	9,770	-86,845
12	60,855	60.47	3,680,183	3,102	23.97	74,358	480	0	-480	61,335	3,102	-58,233
Total	684,948	57.91	39,664,332	195,220	26.44	5,160,831	133,439	157,251	23,812	818,387	352,471	-465,916

Gjithashtu KEK-u ka eksportuar në formë shkëmbimi 157,251 MWh. Dallimi në mes të importit dhe eksportit në formë shkëmbimi është 23,812 MWh, dhe kjo tregon që KEK-u gjatë vitit 2010 më shumë ka eksportuar energji elektrike në formë shkëmbimi se sa ka importuar.

Në përgjithësi, Kosova në vitin 2010 ka qenë neto importuese.




Fig.4.18. Importi, eksporti dhe çmimet në vitet 2005 – 2010

Çmimi i importit të energjisë elektrike nga viti 2005 ka rritje graduale deri në vitin 2008, ku është shënuar çmimi më i lartë prej 112.52 €/MWh, ndërsa në vitet vijuese ka një rënie të ndjeshme të çmimit.

4.8.3 Krahاسimi i çmimeve të importit me vendet e rajonit

Çmimet e importit të energjisë elektrike gjatë vitit 2010 kanë qenë përafërsisht të njëjta me çmimet e rajonit. Figura 4.19 tregon raportin e çmimit të energjisë elektrike të importeve të KEK-ut në vitin 2010 krahasuar me importet në rajon.




Fig. 4.19. Diagrami i çmimit në rajon dhe importit të KEK-ut gjatë vitit 2010

Krahاسimi i çmimeve të rajonit jep një pasqyrë të lëvizjes së këtyre çmimeve gjatë muajve të vitit 2010, megjithatë energjia e shkëmbyer është e një karakteri tjetër ngase krahasimi është bërë me çmimet e tregtisë si: një-ditë-para (day ahead), çmimet brenda ditës (intraday-EEX) dhe të tregtisë dypalëshe (bilaterale) të disa tregjeve evropiane.

5 SHQYRTIMI I TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

5.1 Shqyrtimi i katërt i tarifave të energjisë elektrike

Zyra e Rregullatorit për Energji, në bazë të Nenit 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ka për detyrë të miratojë tarifat në bazë të parimeve të Kreut IX të po këtij ligji.

Gjatë vitit 2010 ZRRE ka bërë shqyrtimin e katërt të tarifave të energjisë elektrike (SHTE4). Shqyrtimi i tarifave është proces interaktiv në mes të ZRRE-së, të të licencuarve dhe palëve të interesit, që ka për qëllim përcaktimin e të Hyrave të Lejuara që shërbejnë për përcaktimin e nivelit të tarifave të energjisë elektrike të KEK-ut dhe nivelit të ngarkesave të KOSTT-it.

Në aplikacionin e tyre për tarifa KEK-u dhe KOSTT-i kanë kërkuar të Hyra të Lejuara prej 170.1 milionë euro që do të paraqiste rritje të tarifës mesatare të energjisë elektrike prej 8.8 %.

Tab.5.1 Kërkesa për tarifën mesatare të energjisë elektrike për vitin 2010

		Miniera	Gjenerimi	Shpërndarja	Furnizuesi	KEK	KOSTT	Gjithsej
Shpenzimet operative (pa blerje të energjisë)	€000s	42,244	30,802	18,714	18,249	110,009	7,978	117,987
Zhvlerësimi	€000s	5,122	4,360	1,071	527	11,081	1,806	12,887
Kthimi i lejuar	€000s	17,115	8,925	4,293	264	30,596	1,587	32,183
Importi	€000s				75,540	75,540		75,540
Blerjet e energjisë jashtë KEK-ut	€000s				2,581	2,581		2,581
Shërbimet ndihmëse	€000s					0	1,624	1,624
Kostot e AQ	€000s	5,066	2,409	1,775	1,758	11,008		11,008
GJITHSEJ KOSTOT E LEJUARA	€000s	69,547	46,496	25,853	98,918	240,814	12,995	253,809
Shitjet ndaj konsumatorëve të kualifikuar	€000s				-23,388	-23,388		-23,388
Eksporti	€000s				-4,430	-4,430		-4,430
Të hyrat tjera operative	€000s	-1,500	-1,624			-3,124		-3,124
Subvencionet	€000s				-50,000	-50,000		-50,000
Përshtatjet	€000s	-1,224	-1,049	-893	-22	-3,187	504	-2,683
GJITHSEJ TË HYRAT E LEJUARA	€000s	66,823	43,823	24,960	21,078	156,685	13,500	170,185
						Tarifa e tanishme	€/kWh	5.58
						Tarifa e kërkuar	€/kWh	6.08
						KËRKESA PËR RRIJTJEN E TARIFËS		8.8%

Sipas Metodologjisë Tarifore, që është pjesë e legjislacionit sekondar të ZRRE-së, të licencuarve duhet t'ju mundësohet që përmes tarifave të energjisë elektrike të mbulojnë shpenzimet e arsyeshme të operimit dhe të mirëmbajtjes së aseteve, shpenzimet e zhvlerësimit, si dhe një nivel të arsyeshëm të profitit. Në kuadër të këtyre parimeve, ZRRE ka lejuar që në të Hyrat e Lejuara të KEK-ut të përfshihen:

- zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar për mbulimin e të gjitha investimeve të planifikuara kapitale;
- të gjitha kostot e arsyeshme operative dhe
- të gjitha kostot për mbulimin e blerjes së energjisë nga importi.

Si rezultat i vlerësimeve të ZRRE-së, të Hyrat e Lejuara që duhet të mbulojnë nga tarifat e rregulluara janë rritur nga 139.7 milionë euro në vitin 2009, në 156.4 milionë euro në vitin 2010 duke përfshirë këtu edhe 18.1 milionë euro për KOSTT-in. Megjithatë, ZRRE ka konkluduar që rritja e kërkesës për energji do t'i mundësojë KEK-ut të mbledhë këto të Hyra pa rritur tarifat e energjisë elektrike dhe, si rezultat, tarifat e energjisë elektrike për vitin 2010 kanë mbetur të pandryshuara¹.

¹ Aplikacionet, qëndrimet e ZRRE-së si dhe komentet e palëve të interesit janë të publikuara në web-faqen e ZRRE-së.

Tab.5.2 Ndarja e të ardhurave të lejuara pas propozimeve të ZRRE-së

		Miniera	Gjenerimi	Shpërndarja	Furnizuesi	KEK	KOSTT	Gjithsej
Shpenzimet operative	€000s	42,244	30,802	18,714	14,848	106,607	7,847	114,454
Zhvlerësimi	€000s	6,877	3,812	1,067	348	12,104	1,857	13,961
Kthimi i lejuar	€000s	16,292	4,696	3,078	76	24,143	934	25,077
Importi	€000s				69,990	69,990		69,990
Blerjet e energjisë jashtë KEK-ut	€000s				2,819	2,819		2,819
Shërbimet ndihmëse	€000s					0	1,624	1,624
Kostot e AQ	€000s	5,138	2,443	1,801	1,783	11,164		11,164
GJITHSEJ KOSTOT E LEJUARA	€000s	70,551	41,753	24,660	89,864	226,828	12,262	239,090
Shitjet ndaj konsumatorëve të kualifikuar	€000s				-22,140	-22,140		-22,140
Eksporti	€000s				-4,430	-4,430		-4,430
Të hyrat tjera operative	€000s	-1,500	-1,624			-3,124		-3,124
Subvencionet	€000s				-50,000	-50,000		-50,000
Përshtatjet	€000s	-1,224	-1,049	-893	-22	-3,187	235	-2,952
GJITHSEJ TË HYRAT E LEJUARA	€000s	67,827	39,080	23,768	13,272	143,947	12,497	156,444
						Tarifa e tanishme	€/kWh	5.58
						Tarifa e kërkuar	€/kWh	5.59
						KËRKESA PËR RITJEN E TARIFËS		0.0%

Vendimi i ZRRE-së është ndikuar në nivel të konsiderueshëm nga rënia e çmimit të energjisë elektrike të importuar prej 112.5 €/MWh në vitin 2008 në 75.77 €/MWh në vitin 2009. Në të njëjtën kohë, subvencionet qeveritare për blerjen e energjisë elektrike nga importi nuk janë zvogëluar për të reflektuar rënien e çmimit të energjisë elektrike.

5.2 Struktura e tarifës së energjisë elektrike sipas divizioneve

Investimet kapitale të aprovuara në kuadër të SHTE4 në divizionin e minierave në vlerë prej 73.5 milionë euro kanë bërë që komponenti i tarifës së minierave të jetë 43% e totalit të tarifës mesatare në Kosovë. Pjesëmarrja e kostonë së gjenerimit në totalin e tarifës mesatare është 24%, shpërndarja dhe furnizimi marrin pjesë me 15.1% dhe 8.4%, respektivisht. Së fundmi pjesëmarrja e KOSTT-it në tarifën mesatare të energjisë është 7.9%.




Fig.5.1 Struktura e tarifës mesatare në vitin 2010

5.3 Parimi i vendosjes së tarifave sipas grupeve të konsumatorëve

Në vlerësimin e tarifave, ZRRE ka marr parasysh, në mes tjerash, edhe nivelin e tensionit ku furnizohet çdo grup i konsumatorëve, sipas profilit të konsumit dhe kostos së shërbimit ndaj tyre. Të Hyrat e Lejuara që janë aprovuar gjatë SHTE4 duhen mbledhur nga nëntë (9) kategori të konsumatorëve, sipas proporcionit në tabelën 5.3.

Tab.5.3 Shpërndarja e kostove lidhur me konsumatorin, energjinë elektrike dhe ngarkesën për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve

Alokimi i të Hyrave		Kosto për konsumat orë	Kosto për ngarkesë	Kosto për energji	Gjithsej
0. Kategoria - 110 kV		0.0%	0.7%	1.3%	2.0%
	€000s	4	1,056	2,063	3,123
1. Kategoria - 35 kV		0.0%	0.3%	0.7%	0.9%
	€000s	6	396	1,071	1,473
2. Kategoria - 10 kV (20 kV)		0.0%	2.0%	3.2%	5.2%
	€000s	23	3,166	5,023	8,212
3. Kategoria I - 0.4 kV komercial me fuqi reaktive		0.0%	1.7%	3.2%	4.9%
	€000s	64	2,642	4,948	7,654
4. Kategoria II - 0.4 kV komercial pa fuqi reaktive		0.7%	5.6%	6.2%	12.5%
	€000s	1,146	8,727	9,674	19,547
5. Kategoria 0.4 kV shtëpiak dy (2) tariforë		8.9%	26.7%	29.3%	64.9%
	€000s	13,862	41,815	45,879	101,556
6. Kategoria 0.4 kV shtëpiak një (1) tarifor		1.4%	2.5%	2.8%	6.6%
	€000s	2,134	3,931	4,302	10,367
7. Kategoria 0.4 kV shtëpiak pa njehsor		0.2%	1.1%	1.2%	2.6%
	€000s	330	1,778	1,955	4,064
8. Kategoria - ndriçimi publik		0.0%	0.1%	0.1%	0.3%
	€000s	20	201	222	443
Gjithsej		11.2%	40.7%	48.0%	100.0%
	€000s	17,589	63,713	75,138	156,440

Në tabelën 5.4 janë të paraqitura tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar të përcaktuara sipas parimeve të theksuara më lartë.

Tab.5.4 Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar të KEK-SH.A., e zbatuar nga data 1 prill 2010

Grupi tarifar	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi tarifar	Njësia	Koha gjatë ditës	Tarifat për 2010	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 31 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		83.83	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.59	5.59
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	€/kWh	Tarifë e lartë	6.49	1.92
			€/kWh	Tarifë e ulët	2.70	1.58
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.08	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.81	5.81
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	€/kWh	Tarifë e lartë	6.79	2.94
			€/kWh	Tarifë e ulët	3.59	2.65
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.58	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.01	5.01
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	€/kWh	Tarifë e lartë	7.61	3.39
			€/kWh	Tarifë e ulët	4.10	3.09
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenjë të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.58	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.91	2.91
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	€/kWh	Tarifë e lartë	8.45	4.69
			€/kWh	Tarifë e ulët	5.33	4.43
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.92	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	10.41	6.73
		Energjia aktive (P), prej së cilës:	€/kWh	Tarifë e lartë	12.53	8.21
			€/kWh	Tarifë e ulët	6.26	4.10
		5	0.4kV matësi 2 tarifarë (2-vlerësh, shtëpiakë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj	
Energjia aktive (P) për konsum:						
<200kWh/muaj (blloku i parë):	€/kWh			Tarifë e lartë	4.64	3.33
	€/kWh			Tarifë e ulët	2.33	1.66
200-600kWh/muaj (blloku i dytë):	€/kWh			Tarifë e lartë	6.43	4.60
	€/kWh			Tarifë e ulët	3.22	2.31
>600 kWh/muaj (blloku i tretë):	€/kWh			Tarifë e lartë	9.33	6.68
	€/kWh			Tarifë e ulët	4.66	3.35
6	0.4kV matësi 1 tarifar (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.08	
		Energjia aktive (P) për konsum:				
		<200kWh/muaj (blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.14	2.96
		200-600kWh/muaj (blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e vetme	5.73	4.10
		>600 kWh/muaj (blloku i tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	8.31	5.96
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:				
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		21.50	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		38.92	
		>600 kWh/muaj			65.58	
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.92	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	8.42	8.42

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.

Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me $\cos(\Phi)=0.95$

Struktura e tarifës së KOSTT-it është e ndarë në tri (3) komponente:

- Ngarkesa për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit që vendoset për mbulimin e kostove të KOSTT-it si pronar i rrjetit të transmisionit. Në këto kosto përfshihen edhe shpenzimet e investimit në rrjet dhe të mirëmbajtjes së rrjetit.
- komponenta për operatorin e sistemit. Kjo komponentë mbulon kostot e KOSTT-it si operator sistemi, dhe përfshinë kostot e blerjes së shërbimeve ndihmëse së bashku me kostot e blerjes së humbjeve të transmisionit.
- Komponenta për Operatorin e Tregut. Kjo komponentë mbulon kostot direkte të KOSTT-it si operator i tregut me shumicë në Kosovë.

Tarifat për vitin 2010 janë të paraqitura në tabelën 5.5.

Tab.5.5 Struktura e tarifave dhe ngarkesave për KOSTT SH.A., të zbatuara nga data 1 prill 2010

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Tarifa 2010
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.287
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.057
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	8.832
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018

6 SEKTORI I NGROHJES QENDRORE

6.1 Pasqyrë e sektorit të ngrohjes qendrore

Sektori i Ngrhjes Qendrore furnizon me ngrohje zonat urbane të komunave: Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan, dhe plotëson rreth 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë. Sistemet e ngrohjes qendrore operohen nga katër (4) ndërmarrje përkatëse: Ngrhitorja e Qytetit "Termokos" SH.A. në Prishtinë, Ngrhitorja e Qytetit "Gjakova" SH.A. në Gjakovë, Njësia Punuese e Ngrhjes Qendrore "Termomit" në Mitrovicë dhe Njësia Punuese e Ngrhjes Qendrore "Zveçan" në Zveçan. Përderisa NQ Termokos dhe NQ Gjakova funksionojnë si korporata – shoqëri aksionare, NjPNQ Termomit dhe NjPNQ Zveçan janë të organizuara si njësi punuese në kuadër të Ndërmarrjeve komunale të Mitrovicës respektivisht Zveçanit.

Zhvillim i rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të furnizimit me energji termike/ngrohje, është hartimi i studimit të fizibilitetit të projektit të ko gjenerimit të energjisë termike nga TC Kosova B për furnizim të sistemit të ngrohjes qendrore në rajonin e Prishtinës. Me këtë parashihet një kapacitet gjenerues i energjisë termike prej rreth 120 MW_t, me të cilin do arrihej një përmirësim i dukshëm në furnizim më të qëndrueshëm dhe kualitativ me ngrohje.

6.2 Karakteristikat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

6.2.1 Impiantet e gjenerimit

Impiantet për gjenerimin e ngrohjes të NQ Termokos përbëhen nga ngrhitorja kryesore me kapacitet të përgjithshëm prej 121.62 MW_t (Megavat termik) dhe ngrhitorja ndihmëse në qendrën klinike universitare me kapacitet prej 14 MW_t. Ngrhitorja e qytetit NQ Gjakova është e pajisur me dy kaldaja me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 38.6 MW_t – njëra me kapacitet gjenerues 20 MW_t dhe tjetra me kapacitet 18.6 MW_t, e cila momentalisht është jashtë funksionit.

Kapacitetet gjeneruese të NjPNQ Termomit në Mitrovicë përfshijnë: ngrhatoren kryesore të pajisur me vetëm një kaldajë funksionale me kapacitet nominal 9.3 MW_t, dhe ngrhatoren në qendrën spitalore që posedon tri kaldaja të vogla me kapacitet të përgjithshëm 7.6 MW_t.

Në NjPNQ Zveçan gjenerimi i ngrohjes mundësohet nga ngrhitorja me kapacitet të përgjithshëm 1.6 MW_t – dy kaldaja me) nga 800 kW_t.

6.2.2 Sistemet e shpërndarjes

Karakteristikë e përbashkët e të gjithë sistemeve të ngrohjes qendrore në Kosovë, është se rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga rrjeti primar që shtrihet deri në pikën e furnizimit në nënstacione, dhe nga rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacione gjer te shfrytëzuesit përfundimtarë.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Termokos ka një gjatësi prej afërsisht 31 km, me kapacitet rreth 300 MW_t. Pjesë integrale e rrjetit të shpërndarjes është edhe stacioni i pompimit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë i cili gjendet në Bregun e Diellit, si dhe 265 nënstacione të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Rrjeti primar i shpërndarjes i NQ Gjakova shtrihet në gjatësi prej rreth 20 km. Pjesë përbërëse e këtij rrjeti janë 249 nënstacione të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar. Matësit e energjisë termike janë instaluar në vetëm 42 nën-stacione.

Sistemi i ngrohjes qendrore në Mitrovicë përmban praktikisht dy rrjete të ndara të shpërndarjes. Pjesa kryesore e rrjetit primar është e lidhur me ngrhatoren kryesore, përderisa pjesa tjetër është e

lidhur me ngrohtoren në qendrën regjionale spitalore. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit primar të shpërndarjes është rreth 4.5 km. Ekzistojnë afërsisht 20 nën-stacione të furnizimit me ngrohje, prej të cilave asnjëra nuk është e pajisur me matës të energjisë termike.

Sistemi i ngrohjes qendrore në Zveçan ka një rrjet të shpërndarjes mjaft të vogël me gjatësi të përgjithshme prej 0.8 km.

Duhet theksuar se, Ngrohtorja Termomit dhe e Zveçanit, për shkak të rrethanave të njohura, nuk i janë përgjigjur kërkesave për licencim dhe monitorim nga ZRRE-ja, kështu që është pamundësuar sigurimi i të dhënave përkatëse të azhurnuara.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore të NQ Termokos dhe NQ Gjakova, paraqitet në tabelën më poshtë.

Tab.6.1 Të dhënat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Ndërmarrja (Qyteti)	Kapaciteti i instaluar [MW _t]	Kapaciteti operacional [MW _t]	Rrjeti i shpërndarjes	
			Gjatësia e rrjetit [km]	Nr. i nënst.
NQ TERMOKOS (Prishtinë)	2 x 58 = 116	2 x 58 = 116		
	2 x 7 = 14	2 x 7 = 14	31	265
	2 x 0,81 = 1.62	2 x 0,81 = 1,62		
	1 x 4 = 4	1 x 4 = 4		
Nën-total	135.62	135.62	31	265
NQ GJAKOVA (Gjakovë)	1 x 20 = 20	1 x 20 = 20	20	249
	1 x 18.6 = 18.60			
Nën-total	38.60	20.00	20	249
Total	174.22	155.62	51	514

6.3 Performansa e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore

6.3.1 Konsumi i lëndës djegëse dhe çmimi

Ngrohtoret e qyteteve janë të pajisura me kaldaja të cilat kryesisht si lëndë djegëse përdorin naftën e rëndë (mazutin), që importohet me çmim referent të bursës plus “premiumi” për mbulimin e shpenzimeve të furnizuesit. Rrjedhimisht çmimi i blerjes së mazutit ndikohet mjaft nga lëvizjet e çmimit në tregjet (bursat) ndërkombëtare; lëvizje këto që kanë qenë mjaft të mëdha dhe drejtpërdrejt kanë ndikuar në koston e lëndës djegëse dhe në koston e përgjithshme të gjenerimit të ngrohjes qendrore.

Më konkretisht çmimet e mazutit me përmbajtje të sulfurit gjer në 1%, gjatë periudhës tetor 2009 – mars 2010, kanë lëvizur nga 339 €/ton – 416 €/ton. Ndërmarrjet e ngrohjes qendrore furnizohen me mazut të llojit që përmban deri në 3.5% Sulfur, dhe siç dihet, çmimi për këtë lloj mazuti kuotohet më ulët për rreth 10-15% se mazuti me 1% përmbajtje sulfur. Në bazë të kësaj mund të përafrojmë se çmimi mesatar i llojit të mazutit me 3.5% Sulfur, për këtë periudhë ka qenë rreth 319 – 337 €/ton.

Në figurën e mëposhtme është dhënë grafiku i lëvizjes së çmimeve për periudhën tetor 2009 – mars 2010, sipas bursës ndërkombëtare Amsterdam-Rotterdam-Antwerp.




Fig.6.1 Çmimi i mazutit në Bursën Ndërkombëtare ARA – periudha: tetor 2009 – mars 2010

Burimi: “U.S. Energy information Administration – Independent statistics and Analysis” – Administrata e Informatave Energjetike të SHBA-ve – Statistikat dhe Analizat e Pavarura

Në fillim të muajit nëntor 2010 çmimi mesatar sillej prej 326.67 €/ton-siç paraqitet në diagramin më poshtë.




Fig.6.2 Çmimi i mazutit në Bursën Ndërkombëtare ARA – periudha: 1 – 5 nëntor 2010

Burimi: www.ProfitQutes.com

Çmimi mesatar i blerjes/furnizimit formohet nga çmimi i bursës të cilit i shtohet edhe komponenta e Premiumit, që për sezonin 2009/2010 ishte 32 €/ton, plus vlera e TVSH-së.

Konsumi i mazutit gjatë sezonit 2009/2010 ka qenë dukshëm më i vogël se konsumi i i sezoneve paraprake, si pasojë e vështirësive financiare të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore që ka pamundësuar furnizim të qëndrueshëm me lëndë djegëse.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare sasia e konsumuar e lëndës djegëse (mazutit) dhe çmimet mesatare të blerjes për sezonin 2009/2010.

Tab.6.2 Konsumi i lëndëve djegëse dhe çmimi mesatar i blerjes për sezonin 2009/2010

Ndërmarrja Sistemi i NQ-së	Mazuti	
	Konsumi (ton)	Çmimi mesatar i blerjes (€/ton)
NQ TERMOKOS	9,337	407
NQ GJAKOVA	1,903	409
Totali i Sektorit të NQ	11,240	408

6.3.2 Gjenerimi, humbjet në sistem dhe furnizimi me ngrohje qendrore

Gjenerimi

Gjenerimi i ngrohjes në sezonin 2009/2010 ka qenë dukshëm më i vogël se parashikimet dhe po ashtu dukshëm më i vogël se në sezonet e kaluara. Kjo veçanërisht ka qenë e shprehur tek NQ Termokos, ku gjenerimi neto i ngrohjes ka qenë 82,987 MW_th, që është 37.23% më i vogël nga sa ishte planifikuar, ndërsa në rastin e NQ Gjakova, gjenerimi neto i ngrohjes ka qenë 15,681 MW_th që është 22.95% më i vogël nga sa ishte planifikuar.

Humbjet në sistem

Humbjet në gjenerim kanë qenë në të njëjtin nivel me sezonet e kaluara duke mos shënuar ndonjë përmirësim të dukshëm. Në sezonin 2009/2010, humbjet në gjenerim të NQ Termokos kanë qenë 21%, ndërsa humbjet në gjenerim të NQ Gjakova kanë qenë 27%. Duhet theksuar se efikasiteti i impianteve gjeneruese është dukshëm nën nivelet e pranuar ndërkombëtare për llojin përkatës të impianteve gjeneruese, e po ashtu dukshëm nën nivelet e planifikuara dhe të lejuara nga ZRRE.

Humbjet në rrjetin e shpërndarjes, gjithashtu mbesin të larta në krahasim me nivelin e zakonshëm të përcaktuar sipas praktikave të avancuara ndërkombëtare. Humbjet në rrjetin e shpërndarje të NQ Termokos në sezonin 2009/2010 kanë qenë 15%, ndërsa humbjet e NQ Gjakova në rrjetin e shpërndarjes kanë qenë 20%.

Furnizimi me ngrohje

Si pasojë e gjenerimit më të ulët edhe furnizimi i konsumatorëve me ngrohje, në sezonin 2009/2010 ka qenë dukshëm më i ulët se i planifikuar.

Furnizimi i konsumatorëve nga NQ Termokos ka qenë 70,575 MW_th, që është 37.20% më i ulët nga furnizimi i planifikuar. Gjendje përafërsisht e njëjtë paraqitet edhe me furnizimin e konsumatorëve të NQ Gjakovës që ka qenë 12,545 MW_th, rreth 30% më i ulët nga ç'ishte planifikuar.

Në këtë aspekt, duhet theksuar se karakteristikë e sezonit 2009/2010 ka qenë përgjithësisht furnizim jo i rregullt dhe me ndërprerje të shpeshta në periudha kohore disaditëshe, dhe përfundimisht me ndërprerjen e furnizimit në gjysmën e dytë të muajit mars, afërsisht një muaj para përfundimit të sezonit të ngrohjes.

Në vijim në mënyrë tabelore dhe grafike, janë paraqitur të përmbledhura të dhënat e gjenerimit dhe furnizimit me ngrohje, si dhe humbjet përkatëse.

Tab.6.3 Performanca energjetike e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore

Ndërmarrja	Energjia e futur nga karburanti	Gjenerimi i ngrohjes	Efikasiteti i ngrohtores		Humbjet e shpërndarjes		Furnizimi
	(MW _t h)	(MW _t h)	(MW _t h)	(%)	(MW _t h)	(%)	(MW _t h)
NQ Termokos	105,508	90,987	22,521	79.00	12,412	15.00	70,575
NQ Gjakova	21,503	16,131	5,792	73.00	2,774	20.00	11,031
Total	127,011	107,118	28,313	78.70	15,186	15.69	81,606




Fig.6.3 Performanca energjetike e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore

6.3.3 Sipërfaqja e shërbimit me ngrohje

Sipërfaqja e përgjithshme e shërbimit e NQ Termokos në sezonin 2009/2010 ka qenë 1,071,677 m², që paraqet një rritje prej 40,745 m² e nga sezoni i kaluar. Grupi i konsumatorëve shtëpiakë merr pjesë me 59.38%, ndërsa grupi i konsumatorëve komercialë e institucionalë me 40.62%.

NQ Gjakova ka pasur sipërfaqen e përgjithshme të shërbimit me ngrohje prej 144,709 m², që gjithashtu paraqet një rritje të ndjeshme prej 24,009m² në krahasim me sezonin e kaluar. Pjesëmarrja e grupit të konsumatorëve shtëpiakë në sipërfaqen totale është 61.86%, ndërsa pjesëmarrja e grupit të konsumatorëve komercialë e institucionalë është 38.14%.

6.3.4 Faturimi dhe arkëtimi

Faturimi i konsumatorëve ende është i bazuar kryesisht në sipërfaqen e ngrohjes (për metër katror). Te një pjesë e vogël e konsumatorëve, faturimi është i bazuar në matjen e energjisë termike të furnizuar, aty ku është e zbatueshme. Edhe këtë vit nuk është arritur niveli i planifikuar i faturimit, kryesisht për shkak të furnizimit jo të rregullt. Në sezonin e ngrohjes 2009/2010 shkalla e arkëtimit për tërë sektorin e ngrohjes qendrore ka shënuar një rënie të vogël në krahasim me sezonin 2008/2009. Siç mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, shkalla mesatare e arkëtimit për sektorin e ngrohjes qendrore është rreth 57%, që paraqet një zvogëlim prej 4% nga sezoni i kaluar.

Tab.6.4 Sipërfaqet e ngrohjes, faturimi dhe arkëtimi 2009/2010

Sezoni i ngrohjes 2009/2010	Sip. ngrohëse [m ²]	Tarifa [€/m ²]	Faturimi (përf. TVSH) [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit [%]
NQ "Termokos", Prishtina					
Amvisëri	636,381	0.84	2,232,166	631,733	28.30
Komercial e Institut.	435,296	1.00	1,878,736	1,638,905	87.23
Total	1,071,677	-	4,110,901	2,270,637	55.23
NQ "Gjakova", Gjakovë					
Amvisëri	89,520	0.90	157,768	89,164	56.52
Komercial e Institut.	55,189	1.28	226,946	210,209	92.62
Total	144,709	-	384,714	299,373	77.82
Total Sektori i NQ	1,216,386		4,495,616	2,570,010	57.17

6.4 Tarifat e ngrohjes qendrore për sezonin 2010/2011

Përderisa sektori i ngrohjes qendrore në transportimin dhe shpërndarjen e ngrohjes klasifikohet si monopol natyror, dhe gjithashtu në gjenerimin dhe furnizimin e ngrohjes ende nuk ekziston konkurrenca, atëherë tarifat e ngrohjes qendrore që i përmbajnë të gjitha komponentët e lartpërmendura i nënshtrohen miratimit nga ZRRE-ja.

ZRRE përcakton tarifat e ngrohjes qendrore, sipas Metodologjisë së Tarifave e hartuar në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Metodologjia tarifore

Për formulimin/llogaritjen e tarifave të ngrohjes qendrore ZRRE ka përzgjedhur dhe zbatuar metodologjinë e Normës së kthimit e ashtuquajtur kosto plus.

Bazuar në Metodologjinë tarifore për përcaktimin e tarifave të ngrohjes qendrore, ZRRE definon të Ardhurat e Lejuara të cilat ndërmarrja e ngrohjes qendrore duhet ti realizoj përmes tarifës, dmth. koston e arsyeshme të lejuar e cila duhet të rikthehet, dhe një normë të arsyeshme të profitit që llogaritet sipas Normës së lejuar të kthimit (RoR) mbi Bazën e rregulluar të aseteve (RAB).

Meqenëse tarifat përcaktohen ex-ante (bazuar në informatat e parashikuara), ZRRE-ja gjithashtu aplikon Bashkërendimin e të Ardhurave të lejuara, i cili bazohet në ndryshimin në mes të Ardhurave të lejuara të projektuara dhe atyre që faktikisht janë realizuar për sezonin paraprak. Rezultati i këtij Bashkërendimi, reflektohet në të Ardhurat e lejuara të sezonit vijues.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur tarifat e ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes qendrore 2010/2011:

Tab.6.5 Përmbledhje e tarifave të ngrohjes qendrore për sezonin 2010/2011

A. TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT PA MATJE			
NDËRMARRJET	Komponentët e tarifave	Konsumatorët shtëpiakë [€/m ² për muaj]	Konsumatorët komercialë e institucionalë [€/m ² për muaj]
NQ TERMOKOS SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	0.06	0.08
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	0.78	0.92
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	0.11	0.14
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	0.79	1.14
B. TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT ME MATJE			
NDËRMARRJET	Komponentët e tarifave	Njësia matëse	Çmimi
NQ TERMOKOS SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	€/kW _t për muaj	0.70
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€/MW _t h	45.50
NQ GJAKOVA SHA	Kapaciteti i ngrohjes i kontraktuar (komp. fikse)	€/kW _t për muaj	1.10
	Ngrohja e furnizuar (komp. variabël)	€/MW _t h	53.67

Grafiket në vijim paraqesin tarifat e ngrohjes qendrore për konsumatorët pa matje dhe për ata me matje.




Fig.6.4 Tarifat e ngrohjes qendrore për konsumatorët pa matje




Fig.6.5 Tarifat e ngrohjes qendrore për konsumatorët me matje

7 PËRKUJDESJA PËR KONSUMATORË DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë në Kosovë, për zgjidhjen e ankesave ndërmjet konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë, operatorëve të sistemit dhe ndërmarrjeve energjetike, si dhe ndërmjet dy ndërmarrjeve energjetike. ZRRE bashkëpunon me të gjitha organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë konsumatorët në sektorin e energjisë. Gjatë këtij viti ZRRE ka regjistruar një numër të madh të ankesave të konsumatorëve. Shumica e ankesave të konsumatorëve kanë qenë kundër vendimeve/përgjigjeve të lëshuara nga KEK-u.

Në proceset dhe vendimet/përgjigjet e përgatitura nga stafi i KEK-ut ka shumë mangësi, mungesë të respektimit të procedurave, të rregullave dhe të ligjeve në fuqi. Si pasojë e këtyre mangësive paraqitet një numër i madh konsumatorëve që kundërshtojnë veprimet e ndërmarra nga KEK-u.

7.1 Ankesat dhe aktivitetet në zgjidhjen e kontesteve

Gjatë vitit 2010 janë regjistruar 243 ankesa të konsumatorëve, prej tyre janë zgjidhur 106 të vitit 2010 dhe 89 ankesa të vitit 2009, që në total janë zgjidhur 195 ankesa. Ankesat e pazgjidhura të vitit 2010 janë në procedurë të kompletimit të dokumentacionit dhe të fakteve relevante për zgjidhjen e tyre.

Ankesat e regjistruara kanë qenë të natyrave të ndryshme: shfrytëzimi i paautorizuar, lexim/faturim i pasaktë, gjobat për shkycje, transfer borxhi, taksa për RTK, etj.

Nga grafiku i mëposhtëm i ankesave të regjistruara shihet se numri më e madh i ankesave të konsumatorëve ka qenë shfrytëzimi i pa-autorizuar, ku pjesëmarrja e tyre në ankesat e përgjithshme ka qenë rreth 63 %.




Fig.7.1 Paraqitja grafike e ankesave të konsumatorëve sipas natyrës së tyre

Gjatë analizës së ankesave janë vërejtur shumë mangësi në proceset e përgatitura nga ana e KEK-ut. Numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2010 sipas kategorisë së konsumatorëve është:

- konsumatorët shtëpiakë, 190 ankesa ose 78%,
- konsumatorët komercialë, 51 ankesa ose 21 %
- konsumatorëve industrialë, 2 ankesa ose 1 %




Fig.7.2 Paraqitja grafike e ankesave të konsumatorëve sipas kategorisë së konsumatorëve

DMK gjatë vitit 2010, ka zhvilluar 700 biseda direkte dhe 205 biseda telefonike me palët, të cilët janë drejtuar për çështje të ndryshme lidhur me ankesa. Gjatë komunikimit me palët, ato janë njoftuar dhe udhëzuar për rregullat, procedurat si dhe të drejtat e tyre në sektorin e energjisë, me qëllim që të jenë sa më mirë të informuar rreth të drejtave të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të konsumatorëve të regjistruar sipas viteve, ku vërehet se numri i ankesave është ende i lartë dhe paraqet një ngarkesë të papërbalueshme për ZRRE-në duke pasur parasysh numrin e kufizuar të stafit.

Tab.7.1 Ankesat e konsumatorëve gjatë viteve

Viti	2006	2007	2008	2009	2010
Ankesat	33	116	572	318	243

8 PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË GAZIT NATYROR NË KOSOVË

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (TKE EJL), Kosova ka filluar kompletimin e kornizës ligjore edhe për sektorin e gazit natyror duke miratuar Ligjin Nr. 03/L-133 për Gazin Natyror. Ky ligj shtrën bazat dhe përcakton organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen ndaj tregut dhe kushtet e kriteret për kryerjen e veprimtarive të bartjes, deponimit, shpërndarjes dhe furnizimit të gazit natyror.

Në Kosovë ende nuk ka gaz natyror, e gjithashtu nuk ekziston infrastrukturë e gazit, përveç rrjetit të vjetër dhe të shkatërruar të gazit artificial nga linjiti, i cili përshkon trasenë me gjatësi të përgjithshme prej 254 km.

Perspektiva e zhvillimit të infrastrukturës dhe furnizimi me gaz natyror në Kosovë, nga institucionet përkatëse të vendit dhe ato ndërkombëtare, është konsideruar si mundësi reale në të ardhmen. Kjo kryesisht për shkak të pozitës gjeostrategjike të vendit tonë në qendër të rajonit të Evropës Juglindore, përmes së cilit parashihen të kalojnë linjat e gazsjellësit që lidhin burimet e gazit natyror në rajonin e Kaspikut dhe në Rusi me vendet e zhvilluara të Evropës perëndimore.

Në këtë kuadër, një ndër objektivat e "Strategjisë së Sektorit të Energjisë së Kosovës" është lidhja e Kosovës me gazsjellësit rajonal në të ardhmen e afërt. Gjithashtu "Studimi i Gazifikimit të Evropës Juglindore" ka propozuar konceptin e "Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë", e cila lidhë shtatë vende të Evropës juglindore, dhe në këtë kuadër ka shqyrtuar mundësinë ekonomike të hyrjes së gazit natyror në Kosovë dhe ka përfunduar se furnizimi i konsumit industrial dhe komercial mund të jetë i realizueshëm.

Është me rëndësi të theksohet përfshirja e Kosovës në raportin "Zhvillimi i Kapaciteteve, Skenarët e Kërkesës dhe furnizimit sipas Shteteve" në kuadër të "Planit Zhvillimor 10 Vjeçar të Rrjetit Evropian të Gazit 2010 - 2019" nga ENTSO G. Ky raport përmban parashikimet për kërkesën e gazit natyror në Kosovë në periudhën 2015 - 2025, dhe planin preliminar për zhvillimin e rrjetit të transmisionit si dhe skemën e shtrirjes së këtij rrjeti që janë për diskutim dhe analizim të mëtutjeshëm. Këto janë përgatitur fillimisht nga MEM në bashkëpunim me ZRRE-në dhe palët tjera të involvuara.

Tab.8.1 Parashikimet për kërkesën e gazit natyror në Kosovë sipas sektorëve

Sektorët	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Gazi natyral si lëndë e dytë e TC me thëngjill	0.00	0.00	246.43	254.35	262.28	270.20	278.13	286.06	293.98	301.91	309.83
Gazi natyral për TC me cikël të hapur&kombinuar	0.00	0.00	0.00	0.00	133.97	138.02	142.07	146.12	150.17	154.22	158.27
Total_NQ	0.00	0.00	78.17	80.51	89.66	99.03	101.89	104.85	107.88	111.01	114.23
Total_industria	10.59	18.12	47.10	84.82	144.85	211.28	261.87	300.73	322.65	335.25	347.44
Total_Ndërtesat Komerciale & Publike	4.25	7.19	23.93	36.58	76.12	107.81	130.13	146.07	152.64	155.81	159.04
Total_Ndërtesat urbane të banimit	5.33	9.33	26.37	38.47	79.54	113.84	140.81	162.17	173.08	180.07	187.19
Totali	20.17	34.64	422.00	494.73	786.42	940.18	1,054.90	1,146.00	1,200.40	1,238.27	1,276.00




Fig.8.1 Plani preliminar i rrjetit të transmisionit të gazit natyror të Kosovës

Burimi: Raporti i ENTSO G “Zhvillimi i kapaciteteve, Skenarët e kërkesës dhe furnizimit sipas shteteve” (ENCO G Report Capacity Development, Demand and Supply Scenarios by Country)

Shënim: Vijat me të kuqe tregojnë linjat e rrjetit të transmisionit të segmentit Kosovar të Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë, ndërsa vijat me të kaltër tregojnë rrjetin e brendshëm të transmisionit.

Në vijim të plotësimit të përgjegjësiave ligjore për zhvillimin e kornizës rregullative dhe obligimeve ndaj TKE EJJ, gjatë vitit 2010 ZRRE ka përcjell zhvillimet rajonale lidhur me gazin natyror dhe ka marrë pjesë aktivisht në punën e Grupit Punues të Gazit në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë dhe të Forumit të Gazit. Në këtë aspekt, ndër tjera ZRRE ka kontribuar në përgatitjen dhe finalizimin e dokumenteve ndër të cilat veçohen:

- “Korniza Rregullative për Zhvillimin e Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë”-dokument për diskutim
- “Modelet e Tregut të Gazit dhe Përputhshmëria e tyre me Rregulloren (EC) 1775/2005” – dokumenti vlerësues
- “Rregullimi i Rrjedhjeve në Transmisionin e Gazit në Komunitetin e Energjisë” Raport final

Të gjitha dokumentet, raportet dhe studimet relevante për gazin natyror gjenden në faqen zyrtare të Traktatit të Komunitetit të Energjisë: www.energy-community.org.

Posaçërisht duhet theksuar punën e filluar në vitin 2010 nga Grupi Punues i Gazit në përgatitjen e dokumentit vlerësues: “Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë nga Teoria në Praktikë”. Ky dokument shqyrton praktikisht të gjitha kërkesat rregullative përfshirë investimet për realizimin e Unazës së Gazit, dhe për këtë qëllim ka zgjedhur dy segmente të Unazës së Gazit; segmentin verior që lidh vendet si: Kroaci-Bosnje e Hercegovinë-Serbi, dhe segmentin jugor që lidhë vendet si: Shqipëri-Maqedoni-Kosovë, të cilat janë paraqitur në figurën në vijim:



Fig.8.2 Segmentet e zgjedhura për shqyrtim – segmenti verior dhe ai jugor

Shënim: Vijat e verdha paraqesin segmentet e gazit të propozuar për shqyrtim.

9 AKTIVITETETI NDËRKOMBËTAR I ZRRE-SË

9.1 ZRRE-ja dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore

Komuniteti i Energjisë së Evropës Juglindore, është themeluar me Traktatin e komunitetit të energjisë të ratifikuar nga të gjitha palët në rajon: Shqipëria, Bulgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova (si UNMIK), Maqedonia (FYROM), Mali i Zi dhe Serbia, dhe është në fuqi që nga 1 korriku 2006. Komunitetit të energjisë në vitin 2010 i është bashkangjitur si anëtar i plotë edhe Moldavia. Me ratifikimin e Traktatit palët nënshkruese janë zotuar që të zbatojnë direktivat përkatëse nga “*acquis communautaire*” në sektorin e energjisë elektrike, gazit, ngrohjes, burimeve të ripërtëritshme dhe ko-gjenerimi, si dhe sigurisë së furnizimit (www.energy-community.org). Paralel me këtë, Këshilli Ministror i TKE më 2009, në formë të amendamentimit të Aneksit të Rregullores KE nr. 1228/2003, ka përkufizuar “Rajonin e Tetë” për kushtet e qasjes në rrjet dhe kushtet e shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë. Shtetet e Rajonit të 8-të janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bulgaria, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Kosova (si UNMIK), Greqia, Sllovenia, si dhe Italia, në pajtim me lidhjet e interkoneksionit me palët aderuese të TE.




Fig.9.1 Tregjet evropiane të energjisë

Një ndër institucionet kryesore të themeluara nga TKE EJA është Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (BRRKE), me përbërje: autoritetet rregullative të palëve kontraktuese; autoritetet rregullative- të shteteve pjesëmarrëse nga: Austria, Bulgaria, Republika Çeke, Qiproja, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia dhe Britania e Madhe, ndërsa statusin e “vëzhguesit” e kanë: Gjeorgjia, Moldavia, Norvegjia, Turqia dhe Ukraina. Ukraina nga viti 2011 do të jetë anëtare me të drejta të plota në TKE të EJA.

Bordi Rregullativ ka të themeluara grupet punuese për: gaz, energji elektrike, konsumatorë dhe grupin punues për Implementimin e Zyrës së Ankandit të Koordinuar për EJL. ZRRE-ja ka të nominuar anëtarët e saj në BRR dhe në çdo grup punues që vepron në emër të Kosovës për çështje rregullative. BRR udhëhiqet nga kryetari i zgjedhur për çdo vit nga përfaqësuesit e rregullatorëve nacionalë, dhe nënkryetarit, i cili është i deleguar nga Komisioni Evropian. Çdo grup punues ka të organizuar nën-grupet për detyra të veçanta.




Fig.9.2 Përbërja dhe grupet punuese me nëngrupe të Bordit Rregullativ të Traktatit të Energjisë për Evropën Juglindore

Synimet dhe prioritetet e BRR gjatë vitit 2010 kanë qenë: zhvillimi i tregut nacional konkurrues në sektorin e gazit dhe të energjisë elektrike, integrimi i tregjeve nacionale dhe heqja e pengesave për aktivitetin ndërkufitar dhe konkurrencën, mbrojtja e konsumatorëve dhe çështjet sociale, aspektet rregullative të sigurisë së furnizimit, siguria e rrjetit elektrik dhe kualiteti i furnizimit, burimet e ripërtëritshme dhe efienca e energjisë.

9.2 Aktivitetet e BRRKE gjatë vitit 2010

Grupi për energji elektrike

- **Nëngrupi TF-1** merret me problematikën e menaxhimit të kongestionit dhe alokimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare, të bazuar në kërkesën e Rregullores 1228/2003 të KE. Me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimi² nga disa OST të rajonit të 8-të, u vendos themelimi i Zyrës së Ankandit (ZA) me seli ne Podgoricë të Malit të Zi. Gjatë vitit 2010 nuk ka pasur ndonjë lëvizje të rëndësishme drejt funksionalizmit të kësaj zyreje, për shkak të mospërkrahjes nga disa OT te rajonit (Serbia, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, etj.) Nëngrupi

² Shqipëria, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Kroacia, etj.

TF-1 ka zhvilluar edhe Modelin për monitorimin rregullativ të rrjedhave ndërkufitare dhe të ZA.

- **Nëngrupi TF-2** - Sistemi Balancues Rajonal ka qenë në fokus të aktiviteteve edhe gjatë vitit 2010. Nëngrupi ka përgatitë vlerësimin rregullativ të Mekanizmit Balancues Rajonal të “**BETSEE**” për EJT. Grupi punues për energji elektrike ka vendosur që në trajtim të kësaj problematike komplekse së pari të shqyrtohet mekanizmi nacional i balancimit shih për këtë edhe është përgatitur raporti i mekanizmave balancues nacional të palëve të TKE të EJT. Ky aktivitet pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2011.
- **Nëngrupi TF-3** - Hapja e Tregut me Shumicë dhe pajtueshmëria e rregullave të tregut mbetet edhe më tutje synim kryesor rajonal. Në vitin 2010 ka përfunduar studimi “**Hapja e Tregut me Shumicë në EJT**”, i përgatitur nga konsulenca e mbështetur financiarisht nga BB. Gjatë përpilimit të këtij studimi nëngrupi i tretë ka pasur inpute të rëndësishme dhe në fokus ka pasur veçmas zhvillimin e planit të veprimit të zbatimit të tij. Në vitin 2011 do të vazhdohet me aktivitetet rreth zbatimit të këtij studimi në rajon.
- **Nëngrupi TF4** - Harmonizimi i licencave ka qenë një aktivitet tjetër i BRR. Posaçërisht aktivitetet lidhur me harmonizimin e licencave për tregtim mbeten prioritet me qëllim të njohjes së ndërsjellë të tyre. Në UE është duke u zhvilluar një diskutim i gjerë për këtë çështje dhe nëngrupi është në pritje të zhvillimeve në UE dhe përfundimet që do të arrihen do të reflektojnë edhe në TKE të EJT.
- **Nëngrupi TF5** – Bashkëpunimi ndërmjet rregullatorëve dhe investimeve ndërkufitare. Gjatë vitit 2010 nëngrupi ka analizuar aspektet rregullative për stimulimin e investime të reja në projekte të infrastrukturës që përfshijnë më shumë se një kufi të palëve kontraktuese të KE të EJT. Bazuar në këtë analizë është përgatitur Raporti “*Instrumentet Rregullative për promovimin e Investimeve të Reja - Vlerësimi i mekanizmave ekzistuese – rekomandimet*”.
- **Nëngrupi TF6** – Monitorimi i tregut në EJT ka qenë në fokus qysh nga 2006, dhe punë më konkrete gjatë vitit 2010 është kryer me projektin me titull “Monitorimi i Tregut në EJT” të financuar nga USAID. Ky projekt përcakton indikatorët dhe pasqyrat e monitorimit të aktiviteteve ndërkufitare. Shpresohet që projekti do të mundësojë qasje të unifikuar të monitorimit duke krijuar një udhëzues për monitorim. Të gjitha të dhënat jepen nga TSO nacionale.

Zyra e ankandit të koordinuar dhe grupi implementues

Gjatë vitit 2010 kanë vazhduar aktivitete rreth themelimit të “Zyrës së koordinuar të ankandit të EJT” (ZKA EJT) që ka për qëllim alokimin e kapaciteteve rajonale dhe menaxhimin e kongestionit në mënyrë të koordinuar në EJT. Gjatë vitit 2010 nuk ka pasur ndonjë përparim të dukshëm rreth funksionalizimit të kësaj zyreje.

Grupi për gaz

Grupi punues i gazit, ka tri nëngrupe punuese për detyra të veçanta, edhe gjatë vitit 2010, është përqendruar në vendosjen dhe harmonizimin e kornizës rregullative për të lehtësuar zhvillimin e “Unazës së Gazit të Komunitetit të Energjisë”, që synon promovimin e infrastrukturës së re dhe asaj shtesë të gazit në Komunitetin e Energjisë. Kjo, me qëllim final të ndërlidhjes së tregjeve nacionale të gazit dhe krijimit të tregut rajonal të gazit të Evropës Juglindore. Rrjedhimisht, ndër detyrat e Grupit Punues të Gazit është implementimi i “*acquis communautaire*” të gazit natyror, tregtia dhe bashkëpunimi ndërkufitar, interkonekcioni dhe bashkëveprimi i linjave të transmissioinit dhe tranzitimit të gazit natyror, dhe harmonizimi i tarifave të transmissioinit. ZRRE ka marrë pjesë aktivisht në punën e GPG, me pjesëmarrje në

takimet e këtij grupi dhe Forumit të Gazit, si dhe me dhënien e informatave, të dhënave dhe komenteve për hartimin e dokumenteve relevante.

Grupi për konsumatorë

Grupi punues për konsumatorë, i ka 5 nëngrupe për detyra të veçanta dhe gjatë vitit 2010, aktivitetet kryesore kanë qenë të lidhura me mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, kualitetin e furnizimit me energji, etj. Në shtator të 2010 është organizuar punëtoria me temë: Mënyra e përmirësimit të pjesëmarrjes së konsumatorëve në proceset rregullative. Në lidhje me kualitetin e shërbimeve dhe matësit elektrik të zgjuar është kryer studimi *“Asistencë për rregullator në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve rregullative në komunitetin e Energjisë”*. Brenda kësaj teme janë organizuar edhe dy punëtori. Në sektorin e gazit është kryer studimi *“Rregullat për tarifa dhe cilësia e shërbimeve të shpërndarjes së gazit në Komunitetin e energjisë”*. Te nëngrupi për faturim është kryer studimi: *“Studimi mbi status quo-në e praktikave të faturimit të Energjisë Elektrike në Komunitetin e Energjisë”*.

Gjithashtu, BRR ka vazhduar rolin këshillëdhënës për Këshillin Ministror të TKEJL në çështje: të monitorimit dhe qasjes së punës të sistemit elektroenergjetik dhe tregut rajonal, me sugjerime për funksionim të rregullt të tregut rajonal; punës drejt një tregu të përbashkët të energjisë elektrike dhe gazit, të hapjes së mëtutjeshme të tregut, njohjes reciproke të licencave në rajon, të marrjes së qëndrimit në lidhje me balancimin rajonal, dhe të krijimit të Zyrës së Ankandit për rajonin e Evropës Juglindore.

Gjatë vitit 2010, në aktivitetet e TKE të ETL Operatori i Transmisionit të Kosovës (KOSTT) ka vazhduar të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në raport me Operatorin e Transmisionit të Serbisë.

ZRRE ka vazhduar edhe në vitin 2010 bashkëpunimin me Sekretariatit e TKE, si në takime të veçanta ashtu edhe duke plotësuar shumë pyetësorë në lidhje me sektorin e energjisë të Kosovës.

9.3 Asociacioni i Rregullatorëve Rajonalë për Energji (ARRE)

Asociacioni i Rregullatorëve Rajonalë për Energji, është organizatë e pavarur e themeluar në vitin 2001, me pjesëmarrje të agjencive të pavarura rregullative në radhë të parë nga shtetet e Evropës Qendrore, rajonit Euro-aziatik, Azisë, Lindjes së Mesme dhe SHBA-ve. Synimet kryesore të ERRA-së janë të nxisë shkëmbimin e informatave dhe zgjerimin e përvojave rregullative në rajon dhe në botë. Sekretariati i ERRA është i vendosur në Budapest të Hungarisë. Financimi i aktiviteteve kryesisht mbulohet nga shtetet anëtare. ZRRE-ja është anëtare e bashkangjitur e këtij asociacioni.

ERRA i ka këto grupe/komitete punuese: Komiteti për licencim dhe konkurrencë, Komiteti për tarifa, Komiteti ligjor, Komiteti i kryetarëve dhe Komiteti për gaz. ZRRE përfaqësohet në të gjitha këto grupe punuese të këtij asociacioni. Më poshtë janë dhënë disa aktivitete kryesore të komiteteve

Komiteti i tarifave

ZRRE në komitetin për tarifa të ERRA-së gjatë vitit 2010 është përfaqësuar në dy takime. Në këtë komitet janë diskutuar çështjet aktuale lidhur me tarifa të shkaktuara nga kriza ekonomike dhe ndikimi në tregjet e energjisë ku si pasojë është paraqitur zvogëlimi i kërkesës dhe i investimeve. Po ashtu, në pajtueshmëri me planin e punës për vitin 2010 janë diskutuar edhe vlerësimi i efikasitetit të Kompanive të Shpërndarjes në shtetet anëtare të ERRA-së, borxhet e këqija, humbjet komerciale si dhe nxitjet për investime në energji të ripërtëritshme.

Komiteti Punues për Licencim dhe Konkurrencë (KPLK)

Gjatë vitit 2010 ZRRE ka marrë pjesë në takimet të KPLK të organizuar nga Asociacioni Regjional i Rregullatorëve të Energjisë, ku është diskutuar për harmonizimin e procedurave të licencimit të shteteve anëtare të ERRRA-s, krizën ekonomike dhe tregjet e energjisë, strukturën e tregut të energjisë elektrike të shteteve anëtare të ERRRA, si dhe masat nxitëse për përkrahjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE.

9.4 Partneriteti ndërmjet Zyrës së rregullatorit për energji dhe Komisionit Komercial të Illinois-it (ICC), SHBA

Një ndër aktivitetet e ZRRE-së gjatë vitit 2010 ka qenë edhe vazhdimësia e partneritetit të nisur në tetor të vitit 2008 në mes të Agjencisë Rregullative të Illinois-it dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji Partneriteti ka vazhduar me takimin e 4^{të} i cili gjatë vitit 2010 është mbajtur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në shtetin e Illinoisit në mes të përfaqësuesve të ZRRE-së dhe ICC-së. Takimet janë mbajtur në: Çikago, Uashington DC, Springfield dhe Bloomington, nga data 9 deri me 13 gusht 2010.

Gjatë takimeve në mes të ZRRE dhe ICC janë diskutuar çështje të ndryshme në interes të dyja palëve, ndër të cilat: shqyrtimi i tarifave, monitorimi i tregut të energjisë, licencimi dhe monitorimi i ndërmarrjeve të energjisë, mbrojtja e konsumatorëve etj. Gjithashtu ka qenë temë diskutimi edhe zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme, vënia e çmimit për këtë energji etj. Për këtë qëllim përfaqësues të ZRRE kanë vizituar një fermë të gjeneratorëve me erë në Bloomington, ku për së afërmi janë informuar lidhur me investimet dhe zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme.

Ky partneritet për shkëmbim përvojash në mes të ZRRE-së dhe ICC-së financiarisht është mbështetur nga USAID-i, përderisa aktiviteti është udhëhequr nga NARUC-u.

Gjatë vizitës në SHBA përfaqësues të ZRRE-së kanë mbajtur takime të përbashkëta edhe me përfaqësues të Komisionit Federal të Rregullatorit për Energji Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar dhe të Asociacionit Kombëtar të Rregullatorëve për Ndërmarrjet e Shërbimeve Publike të SHBA-ve.

Adresat e ZRRE-së**Zyra e Rregullatorit për Energji**

Rruga: Hamdi Mramori nr. 1

Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 247 615

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Tel: +381 (0) 38 247 615 lok. 101

Sekretaria:

Tel: + 381 (0) 38 247 615 lok. 104

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve:

Tel. + 381 (0) 247 615 lok. 116 dhe 125

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org